



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 383 Prot.

Tiranë, më 28.02.2022

V E N D I M

Nr. 41, datë 28.02.2022

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (*në vijim Komisioneri*), bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr.79 regj, datë 29.04.2021, të paraqitur nga Fondacioni “Së Bashku”, kundër Bashkisë Durrës, Bashkisë Krujë, Bashkisë Shijak dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (*në vijim KQZ*), në të cilën pretendohet diskriminimi i personave me aftësi të kufizuara në kuadër të ushtrimit të të drejtës së votës për zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, pala ankuese ka parashtruar se:

Fondacioni “Së Bashku” në zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021, ka patur 16 vëzhgues afatshkurtër (të miratuar nga KQZ), në të gjitha qendrat e votimit, për monitorimin e procesit të votimit për personat me aftësi të kufizuara, në tre bashkitë e Qarkut Durrës: Durrës, Krujë dhe Shijak. Nga monitorimet e kryera nga vëzhguesit e palës ankuese, janë konstatuar këto problematika:

- Ambientet jashtë qendrës së votimit nuk lejojnë hyrjen e personave me aftësi të kufizuara në qendrën e votimit;
- Mungesa e rampave në qendrat e votimit. Në rast të ekzistencës së rampave, ato kanë qenë të papërshtatshme në pjerrësi dhe të paaksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu ka patur mungesë të hekurave shoqërues në rampa;
- Qendra votimi të vendosura në kate të dyta/të treta dhe mungesa e rampave në këto ambiente;
- Qendra votimi të vendosura në ambiente shumë të vogla që nuk lejonin lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara. Mungesa e hapësirës për hyrjen në qendrat e votimit (gjerësi nën 1.2

metra të hapësirës hyrëse). Ambiente brenda qendrave të votimit, korridore të rrëshqitshme dhe mungesa e ndriçimit;

- Mungesa e sinjalistikës në qendrat e votimit për personat që nuk dëgjojnë/nuk shikojnë;
- Mos vendosja në funksionim të dhomës së fshehtë për të votuar personat me aftësi të kufizuara. Në rastet kur dhoma e fshehtë ka ekzistuar është pozicionuar në lartësi mbi parametrat e miratuar nga KQZ (konstatime për lartësinë e dhomës së fshehtë mbi 1.2 m);
- Mungesa e anëtarëve të trajnuar/informuar në qendrat e votimit për procedurat që duhet të ndiqen në rast ushtrimi të së drejtës së votës nga personat me aftësi të kufizuar. Kërkesat e personave me aftësi të kufizuar nuk janë marrë në konsideratë për shkak të mungesës së informacionit nga anëtarët e komisioneve të qendrave të votimit;
- Mos dijenia e anëtarëve të komisioneve të qendrave të votimit për vënien në punë të shablloneve dhe përdorimin e tyre. Mos vendosja në përdorim e shablloneve që ndihmojnë të verbërit për të ushtruar të drejtën e votës (në shumicën e rasteve kanë qenë të ngjitura në mur ose anëtarët e qendrave të votimit nuk kishin informacion pse duhet të përdreshin);
- Mos dhënia e përparësisë për të votuar personave me aftësi të kufizuar në qendrat e votimit.

Pala ankuese shprehet se, konstatimet e mësipërme janë evidentuar bazuar në kushtet minimale që përcakton Udhëzimi i KQZ-së nr.1, datë 05.12.2020 *“Për përcaktimin e rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”* (në vijim Udhëzimi Nr.1, datë 05.12.2020 i KQZ-së)

Pala ankuese deklaron se i është drejtuar zyrtarisht Bashkive Krujë, Durrës dhe Shijak, në lidhje me plotësimin e kushteve në qendrat e votimit për lehtësimin e votimit të personave me aftësi të kufizuar. Në përgjigjet e dërguara nga këto bashki, këto të fundit janë shprehur se i kanë dërguar listën e zgjedhësve për personat me aftësi të kufizuar KQZ, se të gjitha qendrat e votimit plotësonin kushtet për të mundësuar votimin e personave me aftësi të kufizuar dhe se i janë njoftuar vendodhja e qendrave të votimit KQZ.

Pala ankuese shprehet se, i është drejtuar KQZ më dy shkresa zyrtare në lidhje me kushtet e qendrave të votimit, problematikat e hasura ndër vite nga ana e tyre në procesin e votimit dhe në lidhje me trajnimin që duhet të realizohet ndaj anëtarëve të komisioneve të qendrave të votimit për lehtësimin e procesit të votimit për personat me aftësi të kufizuar. Pala ankuese deklaron se, me shkresat nr.1735/1 prot., datë 13.03.2021 dhe nr.2784/1, datë 01.04.2021, KQZ ka konstatuar se janë plotësuar dhe zgjidhur problematikat e parashtruara nga ana e tyre dhe se pjesë e trajnimeve ka qenë edhe trajnimi i anëtarëve të komisioneve të qendrave të votimit mbi ushtrimin e të drejtës së votës nga personat me aftësi të kufizuar.

Sa më sipër pala ankuese kërkon nga Komisioneri:

- Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar në kuadër të ushtrimit të së drejtës së votës për zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021, nga bashkitë Krujë, Durrës dhe Shijak, si rezultat i mosplotësimit të kushteve të qendra të votimit.

- Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar në kuadër të ushtrimit të së drejtës për zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021 nga KQZ për mosmarrjen e masave ndaj anëtarëve të qendrave të votimit për lehtësimin e ushtrimit të së drejtës së votës nga personat me aftësi të kufizuar.
- Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar nga udhëzimi i KQZ-së nr.1, datë 05.12.2020 *“Për përcaktimin e rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”* për mos garantimin e kushteve për ekzistencën e mekanizmave të kontrollit për plotësimin e kushteve në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat e paraqitura nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm, për çështje që lidhen me interesa kolektive.

Bazuar në dispozitën e mësipërme ligjore rezulton se, kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund t’ a bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtëpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit, duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të cënohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 3, pika 11, të ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se : *“Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit.”*

Nga aktet e administruara rezulton se, Fondacioni “Së Bashku” është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me vendimi nr. 427, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur Fondacioni “Së Bashku” nuk pretendon se është cënuar në interesin e tij të ligjshëm dhe të drejtëpërdrejtë, por pretendon diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara në kuadër të ushtrimit të të drejtës së votës për zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021, nga ana e subjekteve kundër të cilëve është paraqitur ankesa.

Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin që t’u përgjigjet nevojave të grupeve të përjashtuara në Shqipëri, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së ankuesit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur, duke vlerësuar përfundimisht se ankuesi legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri shqyrtoi çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.696/1 prot., datë 18.05.2021, Komisioneri ka njoftuar dhe ka kërkuar nga Bashkia Durrës, Bashkia Krujë, Bashkia Shijak dhe KQZ parashtrimet e tyre në lidhje me ankesën, si dhe informacion në lidhje me çështjet e mëposhtme:
 - Sa është numri i votuesve me aftësi të kufizuara dhe sa prej tyre kanë ushtruar të drejtën e votës në bashkitë Krujë, Durrës dhe Shijak?
 - Informacion në lidhje me plotësimin e kushteve të aksesueshmërisë së ambienteve / godinave që kanë shërbyer si qendra votimi në bashkitë Krujë, Durrës dhe Shijak. Informacioni duhet të jepet i detajuar për secilën prej qendrave të votimit dhe për të gjitha aspektet e aksesueshmërisë objekt i ankesës. Informacioni të shoqërohet me kopje të akteve provuese.
 - Informacion në lidhje me standardet e dhomës së fshehtë të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara dhe zbatueshmërinë/respektimin e tyre në praktikë.
 - A janë trajnuar/informuar anëtarët e qendrave të votimit në bashkitë Krujë, Durrës dhe Shijak në lidhje me procedurat që duhet të ndiqen në rast të ushtrimit të të drejtës së votës nga personat me aftësi të kufizuara dhe vënien në punë të shablloneve që ndihmojnë të verbërit për të ushtruar të drejtën e votës dhe përdorimin e tyre? Informacioni të shoqërohet me kopje të akteve përkatëse provuese.
 - A ju është dhënë përparësi për të votuar personave me aftësi të kufizuara në qendrat e votimit? Nëse po, çfarë procedure është ndjekur dhe nëse kjo procedurë ka qenë e formalizuar në ndonjë akt apo rregullore?

- A ka patur ankesa nga ana e votuesve me aftësi të kufizuar në lidhje me marrjen e masave ndaj anëtarëve të qendrave të votimit për lehtësimin e ushtrimit të së drejtës së votës nga ana e tyre? Nëse po, çfarë masash dhe procedurash janë ndjekur për zgjidhjen e tyre apo për nxjerrjen e personave përgjegjës në rast se janë konstatuar shkelje? Informacioni të shoqërohet me kopje të akteve përkatëse provuese?
 - Çfarë masash janë marrë nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me qëllim që të sigurohet kontrolli në lidhje me plotësimin e kushteve në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuar, sipas përcaktimeve të udhëzimit nr.1, datë 05.12.2020?
 - Si dhe çdo informacion tjetër që subjektet do e gjejnë të arsyeshëm se do të ndihmonte në sqarimin e plotë të çështjeve të ngritura në ankesë.
2. Në përgjigje të kërkesës së mësipërme për informacion, subjektet e sipërcituara kanë dërguar pranë Komisionerit, informacionin e mëposhtëm:

2.1 Bashkia Krujë, me shkresën nr. 3262/1 prot., datë 20.05.2021¹, informoi Komisionerin se:

Numri i personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë Krujë të regjistruar për zgjedhjet e 25 Prillit 2021, ishte 832. Nga 92 qendra votimi (*në vijim QV*) që ka patur kjo bashki, 89 QV kanë qenë në katet e para të godinave publike dhe private, të cilat kanë patur vendparkime dhe hapësira të nevojshme për të lëvizur personat me aftësi të kufizuara.

Në zbatim të nenit 5, pika 1 dhe pika 3, germa “b”, të Udhëzimit Nr.1, datë 05.12.2020 të KQZ-së, ishin marrë të gjitha masat për:

- a- Ngritjen e QV-ve në vendodhjen e mëparshme ose sa më afër qendrës së mëparshme;
- b- Kanë patur sipërfaqe më të madhe se 30 m²;
- c- Kanë patur ndriçim të bollshëm;
- d- 89 QV kanë qenë në katet e para të objektit;
- e- Kanë ofruar lehtësira për votimin e personave me aftësi të kufizuara;
- f- Të gjithë zgjedhësit janë njoftuar për vendodhjen e QV-ve.

Bashkia informon se, Komisionet e QV-ve të kësaj bashkie, janë trajnuar nga trajnerët e KQZ-së dhe kanë qenë të pajisur me të gjitha udhëzimet e nevojshme për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuara për të votuar. Komisionet kanë qenë të udhëzuar që në rastet e prezencës të personave me aftësi të kufizuara në QV, atyre t’i jepej përparësi për të votuar duke i ndihmuar sipas nevojës.

Bashkia informon se, gjatë procesit të votimit, por edhe pas tij, nuk ka marrë asnjë ankesë nga personat me aftësi të kufizuar dhe nga asnjë subjekt apo individ tjetër. Sipas Bashkisë, KQZ për çdo ankesë apo pretendim që kanë patur subjekte të ndryshme, ka dërguar dhe ka inspektuar në vend QV dhe kushtet e tyre.

¹ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.696/3 prot., datë 24.05.2021.

Bashkia Krujë ka vendosur në dispozicion edhe të dhënat për ambientet e QV-ve të cilat kanë qenë në juridiksionin e saj, gjatë zgjedhjeve për Kuvend të datës 25.04.2021, ku pasqyrohen të dhëna në lidhje me numrin e QV-së, numrin total të zgjedhësve për çdo QV, vendodhjen e QV-së, llojin e objektit (privat/publik), të dhëna në lidhje me sipërfaqen, aksesin në rrjetin elektrik, katin e QV-së si dhe numrin e personave me aftësi të kufizuar të regjistruar në çdo QV.

2.2 Bashkia Durrës, me shkresën nr. 6082/1 prot., datë 25.05.2021², informoi Komisionerin se:

Numri i votuesve me aftësi ndryshe në Bashkinë Durrës për zgjedhjet për Kuvend të datës 25.04.2021 ka qenë 1126, të ndarë si vijon: - të verbër 701 persona; - paraplegjik 425 persona. Bashkia shprehet se lidhur me ushtrimin e të drejtës së votës për kategorinë e sipërcituar, informacioni duhet të merret pranë KQZ-së.

Për sa i përket kushteve të aksesueshmërisë në ambientet që kanë shërbyer si QV, bashkia shprehet se, pjesa dërrmuese e QV-ve ndodheshin në katin e parë, me qëllim për të lehtësuar hyrjen dhe lëvizjen e personave me aftësi ndryshe. Bashkia shprehet se, shkollat të cilat kanë shërbyer si QV, kanë qenë të pajisura me rampa.

Bashkia shprehet se, masat e marra për votuesit me aftësi të kufizuar gjatë ditës së votimeve, është përgjegjësi e KQZ-së, pasi duke patur një numër shumë të vogël të këtyre personave për çdo qendër votimi, menaxhimi është bërë nga anëtarët e QV-së.

Bashkia Durrës informoi se, pranë saj nuk është paraqitur asnjë ankesë nga personat me aftësi ndryshe lidhur me mosmarrjen e masave nga anëtarët e Komisioneve të QV-ve për lehtësimin e ushtrimit të së drejtës së votës nga ana e tyre.

Bashkia Durrës nuk vendosi në dispozicion informacion të detajuar për secilën prej QV-ve në juridiksionin e saj.

2.3 Bashkia Shijak, me shkresën nr. 3144/1 prot., datë 01.06.2021, informoi Komisionerin se:

Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga Bashkia Shijak, rezulton se numri i votuesve me aftësi të kufizuara të regjistruar për zgjedhjet e 25 Prillit 2021, është 1304, nga të cilët 132 ishin persona të verbër. Bashkia Shijak shprehet se, nuk e disponon informacionin në lidhje me numrin e votuesve me aftësi të kufizuara që kanë ushtruar të drejtën e votës, sepse listat e zgjedhësve janë dorëzuar së bashku me materialet zgjedhore pranë KQZ-së.

Në lidhje me kushtet e aksesueshmërisë së QV-ve, bashkia sqaron se, për të siguruar hyrjen e lirë për në qendrën e votimit të zgjedhësve me aftësi të kufizuar, QV-të ishin caktuar në katet e para të objekteve publike të vëna në dispozicion, sipas urdhrit të KQZ-së drejtuar Komisionit Zonal të

² Protokolluar pranë Komisionerit me nr.696/4 prot., datë 27.05.2021.

Administrimit të Zgjedhjeve nr. 25, për verifikimin dhe evidentimin e QV-ve dhe vendeve të numërimit të votave të cilat mund të kishin problematika dhe nuk përmbushnin kriteret sipas udhëzimit nr. 1, datë 05.12.2020. Pas verifikimit të bërë, në kuadër të detyrave të lëna ishte përcjellë informacioni.

Në lidhje me standardet e dhomës së fshehtë për personat me aftësi të kufizuar, bashkia shprehet se, Komisioni Zonal i Administrimit të Zgjedhjeve ka bërë fillimisht pranimin e materialeve zgjedhore nga KQZ-ja, për të vijuar me shpërndarjen e materialeve zgjedhore më datë 24.04.2021, sipas Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Të gjithë kryetarët e Komisioneve të QV-ve janë pajisur me dhomë të fshehtë standarte dhe dhomë të fshehtë për persona me aftësi të kufizuar. Montimi i tyre është përshtatur sipas QV-ve përkatëse.

Bashkia Shijak, informoi se, anëtarët e Komisioneve të QV-ve janë trajnuar për zbatimin e procedurave ligjore që QV-të nga trajnues të akredituar me vendim të KQZ-së. Trajnimet kanë zgjatur nga data 18.04.2021 deri më 23.04.2021. Anëtarët janë pajisur me materialet e trajnimit dhe i'u është sqaruar mënyra e votimit për zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë. Bashkia sqaron se anëtarët e komisioneve të QV-ve janë trajnuar për t'i dhënë përparësi për të votuar personave me aftësi të kufizuar, por nuk ka patur ndonjë procedurë të formalizuar. Bashkia Shijak informoi gjithashtu, se pranë saj nuk është paraqitur asnjë ankesë nga personat me aftësi të kufizuar.

Bashkia Shijak shprehet se, KQZ-ja në bashkëpunim me Komisionin Zonal të Administrimit të Zgjedhjeve Nr. 25 dhe Komisarariatit të Policisë ka kryer monitorimin e QV-ve, duke verifikuar përshtatshmërinë e kushteve të tyre, veçanërisht për zgjedhësit me aftësi të kufizuar.

2.4 KQZ, me shkresën nr. 5367/1 prot., datë 28.05.2021³, informoi se:

Pas marrjes së njoftimit nga Bashkitë Krujë, Durrës dhe Shijak, KQZ-ja kishte evidentuar vendodhjet e QV-ve, për personat me aftësi të kufizuar, numrin e tyre, llojin e paaftësisë si dhe numrin e zgjedhësve të verbër të njëjësive të vetëqeverisjes vendore përkatëse. Nga informacioni i vendosur në dispozicion nga këto bashki, KQZ-ja vuri në dispozicion të Komisionerit të dhënat e mëposhtme.

Nr.	Qarku	Bashkia	ZAZ	Të verbër	Persona me aftësi të ufizuar (PAK)
1	Durrës	Krujë	20	-	852
2		Durrës	21/22/23/24	700	425
3		Shijak	25	-	78
TOTAL				700	1355

³ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 696/5 prot., date 31.05.2021.

Në lidhje me aksesueshmërinë e godinave të QV-ve, KQZ, shprehet se, në nenin 8, pika c, të udhëzimit të Komisionit Rregullator nr. 1, datë 05.12.2020 *“Për përcaktimin e rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”,* përcaktohet se: *“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, cakton në katet e para të ndërtesave, si rregull, QV-të ku janë të regjistruar zgjedhës me aftësi të kufizuar”.* Gjithashtu, në udhëzuesit që KQZ harton dhe prodhon për t’i ardhur në ndihmë anëtarëve të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe Komisionit të QV, trajtohen të gjitha veprimet për t’i ardhur në ndihmë zgjedhësve me aftësi të kufizuara, duke filluar nga organizimi i QV për të siguruar lehtësi në lëvizjen e tyre, përdorimin e maskës me alfabetin braille, procedurat që zbatohen kur zgjedhësi nuk mund të votojë vetë përmes dhënies së ndihmës së një familjari apo të një zgjedhësi tjetër, në atë QV, referuar parashikimeve të nenit 108 për *“Zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë”,* të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 *“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,* i ndryshuar.

KQZ informon se, në zbatim të ligjit zgjedhor ka mundësuar prodhimin e spoteve publicitare, shoqëruar me gjuhën e shenjave për të bërë të mundur informimin e plotë të personave me aftësi të kufizuar dhe të verbër. KQZ shprehet se ka zhvilluar takime me përfaqësues të shoqatave të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara, me të cilët është diskutuar mbi nevojat dhe plotësimin e tyre në ditën e votimit. Në zgjedhjet e 25 prillit 2021, fleta e votimit është shoqëruar me alfabetin *“Braille”* për të verbërit.

Lidhur me standardet e dhomës së fshehtë për personat me aftësi të kufizuara, KQZ informon se, me vendimin nr. 2, datë 16.12.2020, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ka miratuar modelin dhe specifikimet e dhomës së fshehtë që do të përdoret në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Për zgjedhësit me aftësi të kufizuara, para dhe tetra plegjikë, modeli i dhomës së fshehtë ishte i përshtatur për nevojat e tyre. Ky model i dhomës së fshehtë, i përshtatur për nevojat e zgjedhësve që i përkasin këtij grupimi, KQZ shprehet se, një gjë e tillë erdhi si rezultat i konsultimeve edhe me organizatat civile, përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara të cilët i mundësoj në këtyre zgjedhësve të ushtrojnë vetë të drejtën e votës, duke garantuar fshehtësinë e saj.

Në lidhje me trajnimin e anëtarëve të QV, KQZ shprehet se, në datat 18-23 prill 2021, është realizuar trajnimi i KQZ-së me të gjithë anëtarët e 5199 QV-ve të ngritura për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Pjesë e kurrikulës trajnuese ka qenë edhe udhëzuesi *“Për miratimin e udhëzuesit të Komisioneve të Qendrave të Votimit, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”,* i miratuar me vendimin nr. 16, datë 12.04.2021, nga Komisioni Rregullator në KQZ. Pjesë e këtij udhëzuesi në veçanti dhe e gjithë kurrikulës trajnuese në përgjithësi, kanë qenë edhe procedurat e votimit të parashikuara në nenin 108 të Kodit Zgjedhor, të zgjedhësve, që për arsye fizike nuk janë në gjendje t’i kryejnë vetë ato, apo rastet kur zgjedhësit për *“leximin”* e fletës së votimit, është kërkuar përdorimi i shabllonit braille.

KQZ informoi gjithashtu se, pranë këtij institucioni nuk është paraqitur asnjë ankesë nga ana e ndonjë personi me aftësi të kufizuara, për mosrespektim të së drejtës së tij të votës, në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, nga ana e komisionerëve të QV-ve.

KQZ shprehet se, legjislacioni zgjedhor tej parashikimeve dhe lehtësirave në procedurat e votimit për personat që nuk mund të votojnë vetë, nuk parashikon asnjë gjë të tillë.

KQZ shprehet se është dhe do të vazhdojë të jetë i angazhuar maksimalisht, për të përmbushur me rigorozitet të gjitha parashikimet ligjore dhe nënligjore për garantimin e të drejtës së votës, për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, në mënyrë që në zgjedhjet në vazhdim, përfshirja e tyre të jetë çdo herë e më e madhe, jo vetëm gjatë ditës së votimit, por edhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së procesit zgjedhor.

3. Me shkresën nr. 696/2 prot., datë 18.05.2021, Komisioneri kërkoi nga pala ankuese disa informacione shtesë në lidhje me ankesën, vecanërisht në lidhje me problematikat konkrete të konstatuara sipas QV-ve përkatëse.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, pala ankuese ktheu përgjigje në datën 04.06.2021, në rrugë elektronike në e-mailin zyrtar të Komisionerit info@kmd.al. Në përgjigjen e saj, ndër të tjera, pala ankuese kundërshton pretendimin e KQZ se nuk është paraqitur asnjë ankesë nga personat me aftësi të kufizuara për mosrespektimin e të drejtës së votës në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Pala ankuese shprehet se më datë 03.05.2021, ajo ka përcjellë pranë KQZ-së të gjitha problematikat e konstatuara nga vëzhguesit në Qarkun Durrës dhe bashkëlidhur ka patur edhe foto të konstatimeve të kryerja nga vëzhguesit e palës ankuese gjatë zgjedhjeve.

4. Me shkresën nr. 867/1 prot., datë 15.7.2020, Komisioneri kërkoi nga KQZ informacion nëse, në kuadër të procesit të caktimit të QV, KQZ kishte konstatuar raste kur Bashkitë Durrës, Shijak dhe Krujë, nuk kishin plotësuar kriteret për caktimin e QV-ve, sipas udhëzimit nr. 1, datë 05.12.2020 “*Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendodhjes së qendrave të votimit dhe prgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet*”. Nëse po, cilat QV, në bashkitë e mësipërme, nuk kishin përmbushur kriteret dhe çfarë masash ishin marrë nga ana e KQZ për rregullimin e shkeljeve të konstatuara apo çfarë sanksionesh ishin marrë ndaj subjekteve që ishin konstatuar në shkelje.

Referuar informacionit të KQZ-së dërguar me shkresën nr. 6090/1 prot datë 26.7.2021⁴, rezulton se nuk ka patur konstatime nga ana e KQZ-së për mosplotësimin e kriterëve për caktimin e QV-ve sipas udhëzimit nr. 1, datë 05.12.2020, në lidhje me aspekte të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. KQZ informon se, nuk ka patur ankime nga subjektet zgjedhore, shoqëria apo inspektorët rajonalë për qendra votimi konkrete për mosplotësim në kriterin e

⁴ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.1082/1 prot., date 28.7.2021.

aksesit të personave me aftësi të kufizuara, nga propozimet dhe vendimet e Bashkive Durrës, Shijak dhe Krujë.

5. Bazuar në urdhrin nr. 104, datë 15.07.2021, të Komisionerit, në datën 21.7.2021, u zhvillua një inspektim në Shkollën e Mesme Teknologjike “Hysen Çela”, Gjinnazin “Leonik Tomeo” dhe Shkollën 9-vjeçare “Demokracia”, në Bashkinë Durrës, me qëllim verifikimin e situatës në terren dhe marrjen e informacionit në lidhje me kushtet e aksesueshmërisë së këtyre godinave, të cilat kishin shërbyer si QV në kuadër të zgjedhjeve për Kuvend të datës 25.04.2021. Inspektimi u zhvillua në prezencë të përfaqësuesve të institucioneve arsimore respektive dhe në mungesë të Bashkisë Durrës, e cila edhe pse u njoftua për datën dhe orën e kryerjes së inspektimit nëpërmjet shkresën nr. 1082 prot., datë 15.7.2021, nuk ishte prezent gjatë kryerjes së inspektimit.

Nga inspektimi i realizuar në objektet e mësipërme të cilat kishin shërbyer si QV si dhe deklaratimet e përfaqësuesve të këtyre institucioneve arsimore, rezultoi se:

- Konstatimet e inspektimit të kryer në Shkollën e Mesme Teknologjike “Hysen Çela”:

Me shkresën nr. 251/12 prot., datë 24/03.2021, Shkolla e Mesme Teknologjike “Hysen Çela” ishte njoftuar nga Bashkia Durrës, për caktimin e ambienteve të shkollës si QV Nr. 1441, Nr. 1441/1, Nr. 1442, Nr. 1442/1 dhe Nr. 1442/2. Shkolla kishte caktuar ambientet e QV në katin e dytë të godinës, pasi shkolla ishte në proces rikonstruksioni dhe në katin e parë, kabinetet e praktikave profesionale (kuzhina, restorante etj) nuk ishin të mundura të caktoheshin si QV.

Gjatë inspektimit u konstatua se, shkolla ishte e pajisur me ashensor nga kati përdhe deri në katin e katërt të godinës. Gjithashtu ambientet e jashtme dhe hyrja në godinë kishte akses për personat me aftësi të kufizuara. Përfaqësuesi i institucionit arsimor deklaroi gjatë inspektimit se, shkollës nuk i ishte kërkuar nga ana e KZAZ-s që QV të caktoheshin në katin përdhe të godinës apo të vihej në funksion ashensori për personat me aftësi të kufizuara.

- Konstatimet e inspektimit të kryer në Gjinnazin “Leonik Tomeo”:

Shkolla ishte njoftuar nga Bashkia Durrës për caktimin si QV, në katin e parë të godinës. QV u caktuan në katin e parë të shkak të plotësimit të kushteve për personat me aftësi të kufizuara.

Gjatë inspektimit u evidentua se, hyrja e godinës së shkollës ishte e pajisur me rampë me përmasa: Lartësi 45 cm, Gjatësi 226 cm dhe gjerësi 119 cm. Ndërsa hyrja tjetër e godinës, e cila kishte shërbyer si hyrje në qendrat e votimit të caktuara në këtë shkollë nuk ishte e pajisur me rampë, por përbëhej nga dy shkallë.

- Konstatimet e inspektimit të kryer në Shkollën 9-vjeçare “Demokracia”:

Shkolla ishte njoftuar nga Bashkia Durrës për caktimin si QV. Për shkak të numrit prej 11 QV të caktuara në shkollë, ato u vendosën në katin e parë, të dytë dhe të tretë të godinës. Përfaqësuesi i këtij institucioni arsimor u shpreh se, përfaqësuesit e KZAZ kishin parë vetëm ambientet ku ishin caktuar QV. Sa i përket aksesit të godinës për personat me aftësi të kufizuara, përfaqësuesi i institucionit arsimor, u shpreh se shkolla nuk i plotëson këto standarde dhe për këtë kanë qenë në dijeni përfaqësuesit e Bashkisë Durrës.

6- Bazuar në informacionin e vendosur në dispozicion nga pala ankuese, një regjistrim video i kryer gjatë procesit zgjedhor të datës 25 prill 2021, ku pretendohet se QV-të nr. 1364, 1364/1, 1365 dhe 1365/1, kanë qenë të vendosura në katin e dytë. Me shkresën nr. 1228 prot., datë 26.08.2021, Komisioneri kërkoi informacion nga Bashkia Durrës, nën juridiskrionin e të cilës ndodhen këto QV. Me shkresën nr. 9599/1 prot., datë 10.09.2021⁵, Bashkia Durrës, informoi Komisionerin si vijon:

Qendrat e votimit nr. 1364, 1364/1, 1365, 1365/1, në zgjedhjet e datës 25 Prill 2021 kanë qenë të vendosura në ambientet e lokalit Lavdrim Sulko, në Njësinë Administrative Sukth, përkatësisht në katin e parë të objektit. Vendodhja e qendrave të votimit të lartpërmendura, në zgjedhjet e mëparshme, ka qenë në shkollën 9-vjeçare Kullë, por si pasojë e tërmetit të nëntorit të vitit 2019, kjo shkollë u dëmtua duke e bërë të papërshtatshme procesin e votimit. Për këtë arsye u bë zhvendosja e këtyre qendrave në objektin “Lavdrim Sulko”.

7- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka vendosur të realizojë një seancë dëgjimore në datën 20.09.2021, e cila i’u komunikua palëve me shkresën nr. 1082/2 prot datë 09.09.2021. Në seancë dëgjimore u paraqit KQZ, përfaqësuar me autorizim nga znj. L.M dhe Bashkia Shijak, përfaqësuar me autorizim nga znj. T.P. Në seancë nuk u paraqitën Bashkia Durrës dhe Bashkia Krujë edhe pse kishin rregullisht kanë marrë dijeni sipas lajmërimarrjeve të shërbimit postar. Në seancë nuk u paraqit pala ankuese, e cila njoftoi se e kishte të pamundur pjesmarrjen.

Me shkresën nr. 1431 prot., datë 12.10.2021, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 18.10.2021. Seanca dëgjimore u zhvillua me pjesmarrjen e palës ankuese, përfaqësuar me autorizim nga znj. A.S dhe KQZ-së, përfaqësuar me autorizim nga znj. L.M. Nuk u paraqitën Bashkia Durrës, Bashkia Shijak dhe Bashkia Krujë, të cilat edhe pse kishin rregullisht dijeni për datën dhe orën e zhvillimit të seancës dëgjimore, nuk paraqitën asnjë arsye për mosparaqitjen e tyre.

Gjatë seancës dëgjimore palës ankuese iu la si detyrë që të depozitonte informacionin e detajuar dhe procesverbalet nëpërmjet të cilave ishin evidentuar shkeljet e pretenduara.

⁵ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.1228/1 prot., date 13.09.2021.

Me shkresën me nr. 1431/1 datë 21.10.2021, pala ankuese depozitoi pranë Komisionerit kopjet e pyetësore të mbajtur nga ana e vëzhguesve të angazhuar nga pala ankuese gjatë ditës së zgjedhjeve.

8- Bazuar në informacionin e mësipërm, me urdhrin nr. 180, datë 25.11.2021, të Komisionerit, në datën 06.11.2021, u zhvillua një inspektim në Shkollën 9-vjecare “Rreth” Xhafzotaj dhe Shkollën 9-vjecare “Petrit Llaftiu” në Bashkinë Shijak, me qëllim verifikimin e situatës në terren dhe marrjen e informacionit në lidhje me kushtet e aksesueshmërisë së këtyre godinave, të cilat kanë shërbyer si QV në kuadër të zgjedhjeve për Kuvend të datës 25.4.2021. Inspektimi u zhvillua në prezencë të përfaqësuesve të Bashkisë Shijak dhe përfaqësuesve të institucioneve.

Nga inspektimi i realizuar në objektet e mësipërme të cilat kanë shërbyer si QV si dhe deklaratimet e përfaqësuesve të Bashkisë Shijak dhe drejtuesve të institucioneve arsimore të inspektuara, të pasqyruara në dy procesverbalet e inspektimit, të mbajtur për secilin objekt të inspektuar, rezultoi se:

- Konstatimet e inspektimit të kryer në Shkollën 9-vjecare “Rreth” Xhafzotaj:

Gjatë inspektimit u konstatua se hyrja e shkollës kishte shkallë dhe rampë. Pas matjeve të kryera nga grupi i kontrollit rezultoi me përmasat: 410 cm gjatësia, 184 cm gjerësia dhe 66 cm lartësia. Përfaqësuesit e objektit të inspektuar deklaruan se në këtë shkollë kanë qenë të vendosura tre QV, të cilat kanë qenë në katin e parë të godinës dhe konkretisht QV nr. 1400, 1400/1 dhe 1401.

- Konstatimet e inspektimit të kryer në Shkollën 9-vjecare “Petrit Llaftiu”:

Gjatë kontrollit të realizuar u konstatua se shkolla ishte rikonstruktuar rishtazi dhe gjendet në një godinë së bashku me shkollën “Lidhja e Prizrenit”. Hyrja kryesore për të dy shkollat nuk ka pengesa në hyrje. Shkolla është e pajisur me ashensor. QV në shkollë kanë qenë të vendosura në katin e parë të godinës dhe aksesoheshin nëpërmjet hyrjes kryesore dhe ashensorit. Hyrja për në QV nr. 1389 dhe 1389/1, të cilat kanë qenë të vendosura në shkollën “Petrit Llaftiu” ka qenë nga një hyrje anësore e godinës që shërben si hyrje emergjente. U konstatua se QV, pavarësisht se ishin të pozicionuara në një hyrje anësore e cila kishte shkallë, ishin të aksesueshme nga hyrja kryesore e godinës nëpërmjet ashensorit.

Gjatë inspektimit në dy objektet e mësipërme, grupi i kontrollit realizoi foto dhe video të ambienteve hyrëse dhe atyre të brendshme të godinave.

9- Me shkresën nr. 1657 prot., datë 03.12.2021, Komisioneri kërkoi informacion nga KQZ në lidhje me zgjedhësit me aftësi të kufizuar në Bashkinë Durrës, trajnimet e zhvilluara me të gjithë administratën e përfshirë në procesin zgjedhor në Bashkitë Durrës, Krujë dhe Shijak, fondet e parashikuara nga KQZ për krijimin e kushteve për pjesëmarrjen e personave me

aftësi të kufizuara në zgjedhje, si dhe informacion nëse bashkitë e sipërcituara kishin paraqitur pranë KQZ kërkesë për fonde për krijimin e kushteve për pjesmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në zgjedhje.

Në përgjigje të kërkesës së mësipërme për informacion, me shkresën nr. 7076/1 prot., datë 17.12.2021⁶, KQZ informoi Komisionerin si më poshtë:

Për sa i përket numrit të zgjedhësve me aftësi të kufizuara në Bashkinë Durrës, nga ana e KQZ dispozohen të dhëna të cilat janë dërguar nga kjo bashki. Bazuar në këto të dhëna rezulton se në QV-në nr. 1364, janë 4 votues PAK dhe në QV-në nr. 1365/1 është 1 votues PAK. Në QV-në nr. 1364/1 dhe QV-në nr. 1365 nuk ka votues të kësaj kategorie.

KQZ konfirmon se vendodhja e QV të mësipërme është në katin e dytë. Duke qenë se ato janë qendra votimi në ambiente private janë miratuar me vendim të KQZ-së, në bazë të propozimit nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore. Theksohet se, KQZ (Komisioni Rregullator) me udhëzimin nr. 1, datë 5.12.2020, ka përcaktuar rregullat dhe kriteret e ngritjes së QV-ve, ku përcaktohet shprehimisht: *“...kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, si rregull, cakton në katet e para të ndërtesave qendrat e votimit ku janë regjistruar zgjedhës me aftësi të kufizuara”*. Në ngritjen e qendrës së votimit, krahas këtij kriteri mbahen parasysht edhe kërkesat e tjera si historiku i vendodhjes, kushtet fizike, sipërfaqja etj., pra caktimi i qendrës së votimit duhet të plotësojë njëkohësisht disa kriteret ligjore.

Në lidhje me trajnimet e zhvilluara me administratën e përfshirë në procesin zgjedhor, KQZ informon se, për komisionerët e KZAZ-ve janë zhvilluar trajnime më datat 22 dhe 23 mars 2021, për komisionerët e KQV-ve, trajnimet janë zhvilluar më datat 18-23 prill, ndërsa për komisionerët e KZAZ-ve (trajnimi i dytë) dhe GNV-ve trajnimet janë zhvilluar më datat 23-28 prill. Numri i personave të trajnuar për QV-të e Bashkisë Durrës është 939, për QV-të e Bashkisë Krujë është 35 dhe për QV-të e Bashkisë Shijak është 126.

KQZ, informon se, personat e përfshirë në trajnimin e administratës zgjedhore mbi çështjet që kanë të bëjnë me procesin e votimit për personat me aftësi të kufizuara, nuk kanë dhënë informacione në lidhje me këtë kategori personash. Modulet e trajnimit të zhvilluara nga KQZ-ja krahas informacionit të përgjithshëm mbi procesin e votimit, trajtojnë edhe rastet specifike të votuesve me vështirësi fizike, specifikisht në Udhëzuesin e Komisionit të Qendrës së Votimit ka patur një parashikim në lidhje me ndihmën që ju jepet personave që kanë vështirësi fizike. KQZ është duke hartuar një modul specifik për realizimin e trajnimit, të administratës zgjedhore, që ka të bëjë me procesin e votimit për personat me aftësi të kufizuara.

KQZ-ja shprehet se prej disa vitesh ka si prioritet plotësimin e standarteve për të mundësuar votimin për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara. Për këtë arsye KQZ informon se, për

⁶ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.1657/1 prot date 20.12.2021

çdo QV, pavarësisht faktit nëse ka apo jo votues me aftësi të kufizuara, prodhohen maska për mbajtjen e fletës së votimit në alfabetin *Braille* si dhe dërgohet një dhomë e fshehtësisë për votuesit PAK, në mënyrë që të shprehin vetë vullnetin e tyre.

Në kuadër të programit të edukimit të zgjedhësve, të gjitha spotet edukuese janë shoqëruar edhe me shfaqjen në gjuhën e shenjave, për të mundësuar informimin e plotë edhe të kësaj kategorie votuesish.

KQZ thekson se, në asnjë rast nuk parashikohet që kërkesat për fonde buxhetore nga bashkitë ose institucionet t'i adresohen KQZ-së.

10- Me shkresën nr. 7191/1 prot datë 28.12.2021, KQZ vendosi në dispozicion informacionin në lidhje me numrin e personave me aftësi të kufizuara të detajuar sipas QV dhe llojit të aftësisë së kufizuara, në Bashkinë Durrës, sipas të dhënave që kjo bashki i ka vendosur në dispozicion KQZ.

III. Vlerësimi i fakteve nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

A.1 Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm sa i përket aksesueshmërisë së qendrave të votimit.

Pala ankuese në çështjen në objekt shqyrtimi është një organizatë jofitimprurëse, e cila ushtron veprimtarinë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Pala ankuese ka monitoruar procesin e votimit për personat me aftësi të kufizuara në zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021, në qendrat e votimit në Bashkitë Durrës, Krujë dhe Shijak. Nga monitorimet e kryera nga vëzhguesit e saj, pala ankuese, ka konstatuar problematika (sikundër pasqyrohen më sipër në parashtrimet e palës ankuese) në lidhje me plotësimin e kushteve të QV duke pretenduar në këtë mënyrë se mungesa e aksesueshmërisë në QV ka sjellë diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara në ushtrimin e të drejtës së votës për Zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021, nga ana e Bashkive Durrës, Shijak dhe Krujë, në të cilat ishte kryer procesi i monitorimit të votimit.

Pala ankuese pretendon gjithashtu se, duke dështuar për të marrë masa ndaj anëtarëve të QV për lehtësimin e ushtrimit të të drejtës së votës nga personat me aftësi të kufizuara, KQZ është përgjegjëse për diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara në ushtrimin e të drejtës së votës. Pala ankuese pretendon gjithashtu se personat me aftësi të kufizuara janë diskriminuar nga udhëzimi nr. 1, datë 5.12.2021, i KQZ-së, pasi sipas saj ky akt nuk garanton mekanizma kontrolli për plotësimin e kushteve në QV për personat me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër rezulton se, pala ankuese pretendon diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara në ushtrimin e të drejtës së votës në Zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021 në Bashkitë Durrës, Shijak dhe Krujë.

Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, (në vijim Kodi Zgjedhor), në Kreun IV, Neni 62, pika 4 e në vijim, përcakton se:

“...4. *Vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit, me përjashtim të rastit kur për arsye objektive apo të parashikuara në nenin 93, kjo nuk është e mundur. Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja.*

5. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, jo më vonë se afati i përcaktuar në pikën 4 të nenit 51 të këtij Kodi, cakton dhe shpall vendndodhjen e qendrës së votimit, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni.

.....

9. Jo më vonë se 10 ditë nga përcaktimi i qendrës së votimit, sipas këtij neni, kryetari i njësisë vendore është i detyruar të njoftojë KQZ-në. Njoftimi për vendndodhjen shoqërohet edhe me planimetrinë, llojin e objektit dhe informacione të tjera të përcaktuara në aktin normativ të KQZ-së.

10. *Mbi bazën e informacionit të marrë nga kryetarët e njësisë të qeverisjes vendore, në zbatim të këtij neni, KQZ-ja krijon dhe përditëson hartën e zonave të qendrave të votimit, si dhe krijon bazën e të dhënave mbi vendndodhjet e qendrave të votimit. Përfaqësuesit e partive politike të akredituara në KQZ kanë të drejtë të njihen në çdo kohë me to...”.*

Kodi Zgjedhor, parashikon në nenin 108, të tij disa rregulla të veçanta për mënyrën e votimit nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Në nenin 108, pikat 6, 7 dhe 8, të Kodit Zgjedhor parashikohet : “ 6. *Brenda periudhës së rishikimit të listave të zgjedhësve, zgjedhësit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni kanë të drejtë t’i kërkojnë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, që përgatit listën e zgjedhësve të qendrës përkatëse të votimit, regjistrimin e tyre si zgjedhës që nuk mund të votojnë vetë. Kërkesa për regjistrim shoqërohet me dokumentacionin zyrtar që provon llojin dhe kategorinë e paaftësisë. Regjistrimi si zgjedhës që nuk mund të votojë vetë bëhet për të lehtësuar votimin e këtyre zgjedhësve. 7. Në çdo rast, kur ka zgjedhës të regjistruar, sipas pikës 6 të këtij neni, të cilët kanë vështirësi hyrjeje në mjedisin e qendrës së votimit, caktimi i qendrës së votimit dhe organizimi i saj bëhen në mënyrë të tillë që të garantojnë hyrjen e lirë për këtë kategori zgjedhësish. Në rast se kjo është e pamundur, në përputhje me udhëzimet dhe me shpenzimet e KQZ-së, kryetarët e njësisë të qeverisjes vendore caktojnë personel apo pajisje ndihmëse për të garantuar hyrjen e lirë. 8. Në rastin e zgjedhësve të verbër, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore njofton KQZ-në për numrin e zgjedhësve të verbër dhe qendrat e tyre të votimit. KQZ-ja, në përputhje me procedurat dhe afatet e shpërndarjes së materialeve zgjedhore, pajis komisionet e këtyre qendrave të votimit me mjete të posaçme votimi, të cilat lejojnë zgjedhësit që të lexojnë ose të kuptojnë fletën e votimit dhe të votojnë në mënyrë të pavarur. Zgjedhësi i verbër informohet nga KQV-ja për mënyrën e votimit me mjete të posaçme votimi*

dhe, me kërkesën e tij, pajiset me to. Në rast të kundërt, zgjedhësi voton në përputhje me pikat 1 dhe 3 të këtij neni.”

KQZ (Komisioni Rregullator), ka miratuar udhëzimin nr.1, datë 05.12.2020 “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet” (në vijim vendimi nr.1/05.12.2020). Udhëzimi i sipërcituar, ka për qëllim përcaktimin e rregullave që ndiqen nga organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, për caktimin e zonave dhe vendndodhjes së qendrave të votimit si dhe masat që duhen marrë në qendrat e votimit për garantimin e të drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara.

Neni 3 i udhëzimit, parashikon kriteret për përcaktimin dhe ngritjen e qendrave të votimit, ku përcaktohet se: “1. Vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit, me përjashtim të rastit kur për, arsye objektive apo të parashikuara në nenin 93, të Kodit Zgjedhor, kjo nuk është e mundur.2. Qendrat e votimit krijohen:

a) për aq sa është e mundur në ndërtesa publike me hyrje të lirë;

b) në ndërtesa të institucioneve publike arsimore, kulturore dhe shëndetësore ku përfshihen, shkolla, çerdhe, kopshte, konvikte, qendra shëndetësore, qendra kulturore;

c) në institucione të posaçme ku përfshihen: burgjet, vendet e paraburgimit si dhe spitalet ose institucionet e tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë për më shumë se 3 ditë.

3. KQZ mund të caktojë qendra votimi në ndërtesa private, kur në zonën e qendrës së votimit ose në një zonë qendre votimi fqinje nuk ka mundësi objektive për të përdorur një ndërtesë publike sipas parashikimeve të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni.

Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore i propozon KQZ- së caktimin e qendrës së votimit në ndërtesë private në pronësi të personave fizikë ose juridikë. Propozimi paraqitet me dy objekte alternative, planimetrinë përkatëse ose fotografi të ambientit, një përshkrim për lehtësitë që ofron objekti për zhvillimin normal të zgjedhjeve dhe që plotëson kriteret e përcaktuara në këtë nen. Bëjnë përjashtim rastet kur nuk është e mundur gjetja e një objekti alternativ...”

Në nenin 5, të udhëzimit përcaktohen kriteret teknike dhe pajisjet e qendrës së votimit. Në këtë dispozitë të udhëzimit, parashikohet: “Mjedisi i qendrës së votimit, si rregull, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë me sipërfaqe jo më të vogël se 30 m²;

b) të jetë sa më afër qendrës gjeografike të zonës së qendrës së votimit;

c) të jetë me ndiçim të mjaftueshëm;

ç) të jetë në katet e para të objekteve.

.....3. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, merr masa për: b) pajisjen krijimin e lehtësirave për votimin e personave me aftësi të kufizuara....”

Në nenin 7, të udhëzimit të sipërcituar, përcaktohet se : “1. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, dërgon në KQZ të dhënat e plota për zgjedhësit me aftësi të kufizuara, të cilat përfshijnë: a) qendrën/at e votimit ku janë të regjistruar zgjedhës me aftësi të kufizuara, numrin

e tyre dhe llojin e paaftësisë, për çdo qendër votimi; b) numri i zgjedhësve të verbër të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dërgon në KQZ, të dhënat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, brenda 60 ditëve nga dekretimi i datës së zgjedhjeve”

Në nenin 8, pika 1, germat “a” dhe “b”, të udhëzimit të sipërcituar parashikohet se : “Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore : a) cakton dhe shpall vendodhjen e qendrave të votimit jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i datës së zgjedhjeve; b) cakton në katet e para të ndërtesave, si rregull, qendrat e votimit ku janë të regjistruar zgjedhës me aftësi të kufizuara”

KQZ (Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve) ka miratuar vendimin nr.33, datë 16.12.2020 “Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të dhomës së fshehtë që do të përdoret në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021” (në vijim vendimi nr.33/16.12.2020). Sipas këtij vendimi përcaktohet se : “Për zgjedhësit me aftësi të kufizuara, para dhe tetra plegjikë, modeli i dhomës së fshehtë duhet të jetë i përshtatur për nevojat e tyre.” Me anë të këtij vendimi është miratuar një model i posaçëm i dhomës së fshehtë për personat me aftësi të kufizuara.

Bazuar në kuadrin e mësipërm ligjor rezulton se caktimi i qendrave të votimit dhe infrastruktura mbështetëse, është një detyrim që i atribuohet kryetarëve të njësisë të qeverisjes vendore. Nga aktet e administruara, rezulton se, në kuadër të Zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 prill 2021, KQZ i është i është drejtuar Bashkive Durrës, Shijak dhe Krujë, për dërgimin e informacionit në lidhje me objektet që do të përdoren gjatë procesit zgjedhor si qendra votimi, si dhe plotësimin e formularit tip në të cilin kërkohet evidentimi i zgjedhësve me aftësi të kufizuara, për çdo qendër votimi, respektivisht me shkresat nr. 1948 prot., datë 11.11.2020, nr. 1947 prot., datë 11.11.2020 dhe nr. 1949 prot., datë 11.11.2020.

Bazuar në informacionin e administruar Komisioneri konstaton se, informacioni i vendosur në dispozicion nga ana e KQZ-së lidhur me numrin e personave me aftësi të kufizuara dhe atij të vendosur nga ana e bashkive, nuk është i njëjtë. Bashkia Durrës raporton një numër total prej 1126 persona me aftësi të kufizuara nga të cilët 701 persona të verbër, ndërsa KQZ raporton në total 1125 persona me aftësi të kufizuara nga të cilët 700 persona të verbër. Bashkia Krujë raporton një numër total prej 832 persona me aftësi të kufizuara nga të cilët asnjë votues i verbër, ndërsa KQZ raporton në total 852 persona me aftësi të kufizuara nga të cilët asnjë i verbër. Bashkia Shijak, raporton një numër total prej 1304 persona me aftësi të kufizuara nga të cilët 132 persona të verbër, ndërsa KQZ raporton në total 78 persona me aftësi të kufizuara nga të cilët asnjë votues i verbër. Sipas informacionit të administruar nga tre bashkitë, rezulton se numri total i personave me aftësi të kufizuara është 3262 ndërsa sipas informacionit të raportuar nga KQZ numri total i zgjedhësve me aftësi të kufizuara është 2055.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, pala ankuese pretendon një sërë problematikash që sipas saj kanë sjellë si pasojë diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara në Zgjedhjet për Kuvendin datë 25 prill 2021, por pa specifikuar se në cilën/at qendra votimi është/janë konstatuar problematikat e pretenduara. Bazuar në informacionin dhe provat e administruara gjatë

shqyrtimit të ankesës, Komisioneri ka arritur në konkluzionet e mësipërme sipas bashkive respektive:

- Konstatimet në lidhje me Bashkinë Durrës.

Në informacionin e vendosur në dispozicion nga Bashkia Durrës, kjo e fundit shprehet se pjesa dërmuese e qendrave të votimit ndodheshin në katin e parë të godinave, duke pranuar se detyrimi për vendosjen e qendrave të votimit në katin e parë nuk është respektuar nga ana e saj.

Bazuar në materialet e vendosura në dispozicion nga pala ankuese, Komisioneri arriti të identifikojë disa qendra votimi, për të cilat në vijim të procedurës së shqyrtimit të ankesës kreu verifikimet përkatëse të godinave në të cilat ishin vendosur këto QV.

Në bazë të inspektimit të realizuar nga Komisioneri, rezultoi se, qendrat e votimit 1441, 1441/1, 1442, 1442/1 dhe 1442/2 me vendodhje Shkolla e Mesme Teknologjike “Hysen Çela”, kanë qenë të vendosura në katin e dytë, në kundërshtim me udhëzimin nr. 1/05.02.2020 të KQZ-së. Bashkia Durrës nuk vendosi në dispozicion informacionin e detajuar në lidhje me zgjedhësit me aftësi të kufizuar sipas qendrave të votimit dhe llojit të aftësisë së kufizuar. Bazuar në informacionin e vendosur në dispozicion nga KQZ-ja, rezulton se Bashkia Durrës ka raportuar pranë KQZ-së, se në këto qendra votimi janë të regjistruar, 4 zgjedhës me aftësi të kufizuara të cilët nuk klasifikohen në ndonjë nga kategoritë që aktualisht gëzojnë status duke u raportuar si persona me aftësi të kufizuar, 11 zgjedhës me aftësi të kufizuar në shikim dhe asnjë zgjedhës para/tetraplegjik dhe invalid pune.

Bazuar në informacionin e administruar nga inspektimi i kryer në Shkollën “Hysen Çela”, rezultoi se godina ishte rikonstruktuar rishtazi dhe ishte e pajisur me ashensor nga kati i parë deri në katin e fundit të godinës. Gjithashtu, gjatë inspektimit u konstatua se, ambientet e jashtme dhe hyrja në godinë kishte akses për personat me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër, Komisioneri nuk konstaton problematika që lidhen me mungesën e aksesin në godinën ku kanë qenë të vendosura qendrat e votimit 1441, 1441/1, 1442, 1442/1 dhe 1442/2 me vendodhje Shkolla e Mesme Teknologjike “Hysen Çela”. Pavarësisht se këto QV, nuk kanë qenë të vendosura në katin e parë të godinës, rezulton se ato mund të aksesoheshin nga personat me aftësi të kufizuara nëpërmjet ashensorit dhe se gjithashtu ambientet e jashtme dhe hyrja e godinës kishte akses për personat me aftësi të kufizuara. Pala ankuese nuk parashtroi fakte ose prova, por as ngriti pretendime se persona me aftësi të kufizuar kanë kërkuar të aksesojnë qendrën e votimit nëpërmjet ashensorit dhe nuk iu është vendosur në dispozicion.

Komisioneri, bazuar në aktet e administruara kreu verifikime në QV-të 1457, 1457/1, 1457/2, 1459, 1459/1, 1460 dhe 1460/1, me vendodhje në Shkollën “Leonik Tomeo”, të cilat u identifikuan nga pamjet fotografike të depozituara nga pala ankuese. Sipas informacionit të administruar nga KQZ, Bashkia Durrës ka raportuar se në këto qendra votimi janë regjistruar

gjithsej 17 zgjedhës me aftësi të kufizuara, nga të cilët 11 zgjedhës me aftësi të kufizuara në shikim, 6 zgjedhës me aftësi të kufizuara që nuk i përkasin ndonjërit nga statutet dhe asnjë zgjedhës para/tetraplegjik dhe invalid pune.

Nga inspektimi rezultoi se QV-të e mësipërme kanë qenë të vendosura në katin e parë të godinës, por hyrja e godinës, e cila kishte shërbyer si hyrje në qendrat e votimit të caktuara në këtë shkollë, nuk ishte e pajisur me rampë, por përbëhej nga dy shkallë.

Rezultoi se hyrja kryesore e godinës së shkollës ishte e pajisur me rampë me përmasat:

- Lartësi 45 cm;
- Gjatësi 226 cm;
- Gjerësi 119 cm.

Përsa më lart, nga përmasat e siguruara gjatë matjes së rampës dhe përlllogaritjes sipas Teoremës së Sinusit, u arrit të evidentohet se ajo kishte një pjerrtësi rreth 11° ose rreth 6.1 %.

Për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”. Ky vendim përcakton masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjanohe pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara. Sipas këtij vendimi, janë pengesa infrastrukturore: a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtudo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përhershme ose të përkohshme; b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse; c) mungesa e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve e të burimeve të rrezikut për këdo dhe, në veçanti, për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar (Kreu I, pika 3). Ky vendim është i detyrueshëm si ndaj sektorit publik ashtu edhe atij privat, përfshin si ndërtesat e reja ashtu edhe ato ekzistuese, e në mënyrë të veçantë ato mjedise ku ofrohen shërbime publike. (Kreu I, pika 4).

Sipas pikës 2, të kreut 2, të kësaj VKM-je, çdo kërkesë teknike për përshtatshmërinë e objekteve të reja dhe atyre ekzistuese, parqeve, shesheve dhe rrugëve zbatohet sipas dispozitave të parashikuara në vendimin nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”. Ndër të tjera, në këtë rregullore parashikohet sa më poshtë vijon:

Në Kreun I, neni 1, pikat 19, 20, 21 dhe 22, përcaktohet se : “19. Përpunimi relievor - është përpunimi përfundimtar me reliev i sipërfaqes së ecjes. 20. Vija relievore drejtuese - është përpunimi me reliev i sipërfaqes së ecjes e dedikuar për drejtim të lëvizjes së personave që nuk shikojnë dhe/ose me shikim të dobësuar, e cila në fund të rrugës dhe në vendin e ndërrimit të drejtimit të lëvizjes përcakton atë me ndërrimin e strukturës relievore me gjerësi së paku 40 cm.

21. Vija relievore paralajmëruese - është përpunim me reliev i sipërfaqes së ecjes, e cila vendoset me qëllim të paralajmërimit të personave që nuk shohin dhe/ose me shikim të dobësuar për rrezikun nga komunikacioni. 22. Fusha relievore paralajmëruese - është përpunimi me reliev i sipërfaqes së ecjes, e cila shërben për paralajmërim të personave që nuk shikojnë dhe/ose me shikim të dobësuar të ndryshimit të nivelit të lëvizjes.”

Në Pjesën e dytë të Rregullores, Kreu IV, neni 8, pikat 2.10 dhe 2.11, përcaktohet se:
“.....2.10. Para shkallës së parë dhe mbas asaj të fundit realizohet fusha relievore paralajmëruese në gjatësinë e plotë të krahut të shkallëve dhe me gjerësi 40 cm me vijëzime pingul me drejtimin e lëvizjes,2.11 “Platformat e pjerrëta (rampat)” - Konsiderohet i arritshëm kalimi i një disnivele deri në 320 cm nëpërmjet platformave të pjerrëta të vendosura njëra pas tjetrës. Rampa duhet të plotësoj kushtet:

- pjerrtësi të lejuar deri në 1:20 (5%);
- gjerësi së paku 120 cm në hapësirat e jashtme, gjegjësisht më së paku 90 cm në hapësirat e brendshme;
- shesh pushime horizontale me dimensione minimale prej 150 x 150 cm ose 140 x 170 cm në drejtim të tërthortë dhe 170 cm në drejtim gjatësor nga ana e kundërt e lëvizjes, e vendosur në çdo 10 m të gjatësisë së rampës,
- sipërfaqe relievore kundër rrëshqitëse;
- rrethim të ndërtuar me doreza mbajtëse në pjesën e pambrojtur, ose në pamundësi një bordurë të paktën me 10 cm lartësi;
- dorezë mbajtëse me diametër 4 cm, e formatuar në mënyrë që mund të kapet me pëllëmbë, e vendosur në dy lartësi - prej 60 cm dhe 90 cm;
- rrethim i rampës, i cili gjendet në hapësirat e jashtme, doreza mbajtëse e tij e realizuar në mënyrë të tillë që të mos jetë e ndjeshme nga ndryshimet termike;
- rrethim me sipërfaqe prej qelqi i shënuar dukshëm;
- përdorim i shenjave të përshtatjes

Pjerrësia e platformave nuk duhet t'i kalojë 8%. Janë të pranueshme pjerrësi më të larta, në rastet e përshtatshmërisë, të lidhura me zhvillimin linear efektiv të platformës.....”.

Referuar standarteve teknike që duhet të përmbushi rampa sipas rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” dhe bazuar në pamjet fotografike të administruara dhe matjet në terren të rampës që ndodhej në hyrjen kryesore të godinës ku ishin vendosur qendrat e votimit, rezultoi se rampa nuk përmbush të gjitha aspektet teknike të parashikuara nga rregullorja e mësipërme. Konkretisht:

- Gjerësia e rampës është më e vogël se ajo e përcaktuar nga Rregullorja “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”;
- Mungon totalisht rrethimi i ndërtuar me doreza mbajtëse, sipas specifikimeve të mësipërme të parashikuara nga Rregullorja “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”;

Në godinën ku kanë qenë të vendosura QV-të e sipërcituara, mungojnë vijat relievore që kanë si qëllim të drejtojnë dhe orientojnë personat me aftësi të kufizuara që nuk shikojnë. Mungesa e fushës relievore paralajmëruese konstatohet nga pamjet fotografike të administruara edhe në pjesën e shkallëve, një aspekt teknik ky i detyrueshëm sipas Rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”.

Bazuar në aktet e administruara u kryen verifikime për QV-të 1433, 1433/1, 1498, 1498/1, 1432/1, 1431/1, 1431/2, 1432/2, 1432, 1431 dhe 1432/3 me vendodhje në Shkollën 9-vjeçare “Demokracia”, të cilat u identifikuan nga pamjet fotografike të depozituara nga pala ankuese. Sipas informacionit të administruar nga KQZ, Bashkia Durrës ka raportuar se në këto qendra votimi janë regjistruar gjithsej 45 zgjedhës me aftësi të kufizuara, nga të cilët 27 zgjedhës me aftësi të kufizuara në shikim, 18 zgjedhës me aftësi të kufizuara që nuk i përkasin ndonjërit nga statuset dhe asnjë zgjedhës para/tetraplegjik dhe invalid pune.

Nga inspektimi rezultoi se, QV-të e mësipërme nuk kanë qenë të vendosura të gjitha në katin e parë të godinës, por të shpërndara në katin e parë, të dytë dhe të tretë. Gjatë inspektimit të realizuar në Shkollën 9-vjeçare “Demokracia”, rezultoi se hyrja e godinës nuk ishte e aksesueshme, pasi ishte e pajisur me shkallë dhe nuk ishte e pajisur me rampë. Godina në të cilën kanë qenë të vendosura dhe të regjistruar një numër i konsiderueshëm QV dhe zgjedhësish me aftësi të kufizuara, nuk plotësonte asnjë standart në lidhje me aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

Komisioneri kreu verifikime për QV-të 1364, 1364/1, 1365 dhe 1365/1, të vendosura në ambientet e lokalit “Lavdrim Sulko”, Kullë, Njësia Administrative Sukth, bazuar në regjistrimin video të depozituar nga pala ankuese, ku pretendohet se këto QV ishin të vendosura në katin e dytë të godinës. Sipas informacionit të administruar nga KQZ, Bashkia Durrës ka raportuar se në këto qendra votimi janë regjistruar gjithsej 8 zgjedhës me aftësi të kufizuara, nga të cilët 4 zgjedhës me aftësi të kufizuara në shikim, 4 zgjedhës me aftësi të kufizuara që nuk i përkasin ndonjërit nga statuset dhe asnjë zgjedhës para/tetraplegjik dhe invalid pune.

Me shkresën nr. 9599/1 prot., datë 10.09.2021, Bashkia Durrës, informoi Komisionerin se të gjitha QV-të e mësipërme kanë qenë të vendosura në katin e parë të godinës. Gjatë hetimit të realizuar dhe bazuar në informacionin dhe aktet e vendosura në dispozicion nga ana e KQZ-së me shkresën nr. 7076/1 prot., datë 17.12.2021, në lidhje me QV-të e mësipërme, rezultoi se pretendimi i Bashkisë Durrës nuk është i bazuar. QV-të 1364, 1364/1, 1365 dhe 1365/1 kanë qenë të vendosura në katin e dytë të godinës dhe nuk rezultojnë që kjo godinë të jetë e pajisur me ashensor.

- **Konstatimet në lidhje me Bashkinë Shijak.**

Bazuar në aktet e administruara u kryen verifikime për QV-të 1389 dhe 1389/1 me vendodhje në Shkollën 9-vjeçare “Petrit Llaftiu”, të cilat u identifikuan nga aktet e depozituara nga pala

ankuese. Sipas informacionit të administruar Bashkia Shijak, raporton se në këto dy qendra votimi janë regjistruar gjithsej 95 zgjedhës me aftësi të kufizuara, nga të cilët 4 zgjedhës me aftësi të kufizuara në shikim, 20 zgjedhës me aftësi të kufizuara që nuk i përkasin ndonjërit nga statuset, 70 zgjedhës që kanë zatusin si invalid pune dhe 1 zgjedhës paraplegjik.

Nga inspektimi i kryer në Shkollën “Petrit Llaftiu” rezultoi se, të dy QV e vendosura në këtë godinë kishin qenë në katin e parë. Hyrja për tek qendrat e votimit ishte nga një hyrje anësore e godinës dhe jo nga hyrja kryesore. Hyrja që ka shërbyer për të aksesuar QV-të kishte disa shkallë dhe nuk ishte e pajisur me rampë.

Gjatë inspektimit u konstatua, sikurse rezultoi edhe nga procesverbali i mbajtur dhe pamjet filmike dhe fotografike të marra gjatë inspektimit, se hyrja kryesore e shkollës nuk kishte pengesa dhe shkolla ishte rikonstruktuar rishtazi. Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se hyrja që ka shërbyer për të aksesuar qendrat e votimit ka patur në hyrje të saj shkallët si barriera për personat me aftësi të kufizuara, QV-të ishin të aksesueshme nga hyrja kryesore e shkollës ku nuk u konstatuan pengesa dhe godina ishte e pajisur me ashensor, nëpërmjet të cilit sikurse u verifikua nga grupi i inspektimit mund të aksesoheshin normalisht QV-të e vendosura në këtë shkollë. Komisioneri evidenton faktin se, pala ankuese nuk parashtroi fakte ose prova, por as ngriti pretendime se persona me aftësi të kufizuar kanë kërkuar të aksesojnë qendrat e votimit nëpërmjet ashensorit dhe nuk iu është vendosur në dispozicion.

Në Bashkinë Shijak, Komisioneri kreu verifikime edhe për QV-të 1400, 1400/1 dhe 1401, të vendosura në Shkollën 9-vjeçare “Rreth” Xhafzotaj. Sipas informacionit të administruar Bashkia Shijak, raporton se në këto qendra votimi janë regjistruar gjithsej 47 zgjedhës me aftësi të kufizuara, nga të cilët 5 zgjedhës me aftësi të kufizuara në shikim, 25 zgjedhës me aftësi të kufizuara që nuk i përkasin ndonjërit nga statuset, 14 zgjedhës që kanë statusin si invalid pune dhe 3 zgjedhës para/tetraplegjik.

Nga inspektimi i kryer në Shkollën 9-vjeçare “Rreth” Xhafzotaj, rezultoi se hyrja e godinës nuk kishte pengesa. Hyrja ishte e pajisur me shkallë dhe me rampë. Nga matjet e realizuara dhe të pasqyruara në procesverbalin e mbajtur gjatë inspektimit rezultoi se, rampa ka përmasat e mëposhtme:

- Lartësi 66 cm;
- Gjatësi 410 cm;
- Gjerësi 184 cm.

Përsa më lart, nga përmasat e siguruara gjatë matjes së rampës dhe përlllogaritjes sipas Teoremës së Sinusit, u arrit të evidentohet se ajo kishte një pjerrtësi rreth 9° ose rreth 5 %.

Referuar standarteve teknike që duhet të përmbushi rampa sipas rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” dhe bazuar në pamjet fotografike/filmike të administruara, rezultoi se rampa nuk përmbush të gjitha aspektet teknike të parashikuara nga rregullorja e mësipërme. Konkretisht, mungon totalisht rrethimi i ndërtuar me doreza mbajtëse,

sipas specifikimeve të mësipërme të parashikuara nga Rregullorja “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”;

Në godinën ku kanë qenë të vendosura QV-të e sipërcituara, mungojnë vijat relievore që kanë si qëllim të drejtojnë dhe orientojnë personat me aftësi të kufizuara që nuk shikojnë. Mungesa e fushës relievore paralajmëruese konstatohet nga pamjet fotografike të administruara edhe në pjesën e shkallëve, një aspekt teknik ky i detyrueshëm sipas Rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”.

- **Konstatimet në lidhje me Bashkinë Krujë.**

Bazuar në informacionin e vendosur në dispozicion, Komisioneri nuk identifikoi asnjë qendër votimi në Bashkinë Krujë, ku pala ankuese të ketë konstatuar problematikat e ngritura në ankesë, në mënyrë që të vijohej më tej me verifikimet përkatëse.

- **Përfundime.**

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, godina e Shkollës “Leonik Tomeo” ku kanë qenë të vendosura qendrat e votimit 1457, 1457/1, 1457/2, 1459, 1459/1, 1460 dhe 1460/1; godina e Shkollës 9-vjeçare “Demokracia”, ku kanë qenë të vendosura qendrat e votimit 1433, 1433/1, 1498, 1498/1, 1432/1, 1431/1, 1431/2, 1432/2, 1432, 1431, 1432/3, si dhe godina ku kanë qenë të vendosura qendrat e votimit 1364, 1364/1, 1365, 1365/1, ambientet e lokalit “Lavdrim Sulko”, Kullë, Njësia Administrative Sukth, nuk përmbushin të gjitha standardet teknike të miratuara për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, e për rrjedhojë Bashkia Durrës, si subjekti i cili duhet të kishte siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, nuk ka përmbushur të gjitha detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë në qendrat e votimit.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, godina e Shkollës 9-vjeçare “Rreth” Xhafzotaj, ku kanë qenë të vendosura qendrat e votimit 1400, 1400/1 dhe 1401, nuk përmbush të gjitha standardet teknike të miratuara për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, e për rrjedhojë Bashkia Shijak, si subjekti i cili duhet të kishte siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, nuk ka përmbushur të gjitha detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë në qendrat e votimit.

Meqënëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara, Komisioneri vlerëson se dështimi për të përmbushur standartet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë për të shprehur të drejtën e votës në Zgjedhjet për Kuvend të datës 25.04.2021, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe në rastin konkret, në raport me zgjedhësit e tjerë.

Gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, nuk u konstatuan shkeljet e ngritura nga pala ankuese në lidhje me Bashkinë Krujë.

Komisioneri konstaton me shqetësim mospërputhje midis të dhënave të raportuara nga ana e bashkive dhe KQZ-së, për sa i përket numrit të zgjedhësve me aftësi të kufizuara, qendrat e votimit, si dhe llojin e aftësisë së kufizuar bashkë me nevojat e tyre. Bashkitë të cilat janë përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave, duhet të jenë më të përgjegjshme për mbledhjen e të dhënave të sakta, ndërkohë që mospërputhja e konstatuar gjatë kësaj procedure tregon për nevojën që KQZ duhet të monitorojë më me kujdes këtë proces. Mbledhja e saktë e të dhënave paraprake në lidhje me zgjedhësit me aftësi të kufizuara është shumë e rëndësishme për të adresuar nevojat dhe për të eliminuar barrierat gjatë procesit zgjedhor. Mbledhja e të dhënave të sakta është një aspekt thelbësor i cili kontribuon në garantimin e të drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara.

A.2 Lidhur me me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm sa i përket funksionimit të dhomës së fshehtë të votimit.

Me anë të vendimit nr.33/16.12.2020, KQZ (Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve) ka miratuar një model i posaçëm të dhomës së fshehtë për personat me aftësi të kufizuara me qëllim që të garantohet votimi dhe fshehtësia e votës në baza të barabarta me zgjedhësit e tjerë.

Sa i përket pretendimit të palës ankuese, se dhoma e fshehtë për të votuar personat me aftësi të kufizuara nuk është vendosur në funksionim ose në rastet kur është vendosur ka qenë e pozicionuar jo në lartësinë e duhur dhe të miratuar nga ana e KQZ-zë, Komisioneri nuk arriti të sigurojë prova dhe fakte, nëse ato ishin vendosur nga personat përgjegjës bazuar në kriteret e përshtatshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Në këtë kuadër, Komisioneri nuk mund të shprehet nëse dhoma e fshehtë në qendrat e votimit në Bashkitë Durrës, Krujë dhe Shijak, ishin vendosur në mënyrë të përshtatshme që personat me aftësi të kufizuara të shprehnin të drejtën e votës në baza të barabarta me të tjerët.

A.3 Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm nga ana e KQZ-së.

Në lidhje me pretendimin për trajtim të padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm nga ana e KQZ-së pala ankuese pretendon se ky i fundit nuk ka marrë masa ndaj anëtarëve të qendrave të votimit për lehtësimin e ushtrimit të së drejtës së votës nga personat me aftësi të kufizuara dhe për shkak se udhëzimi nr. 1, datë 05.12.2020, i miratuar nga ana e KQZ-së (Komisioni Rregullator), nuk parashikon mekanizma të kontrollit për plotësimin e kushteve të qendrave të votimit për personat me aftësi të kufizuara.

Në lidhje me pretendimin e parë kundër KQZ-së, Komisioneri konstaton se, pala ankuese nuk paraqiti asnjë rast konkret kur anëtarët e qendrave të votimit kanë cënuar ushtrimin e të drejtës së votës nga personat me aftësi të kufizuara dhe për këto raste të ketë kërkuar marrjen e masave ndaj anëtarëve nga ana e KQZ-së. Rezulton se pala ankuese dhe KQZ kanë patur korrespondencë përpara datës së zgjedhjeve por edhe pas përfundimit të procesit zgjedhor. Bazuar në korrespondencën që palët kanë shkëmbyer me njëra tjetrën, Komisioneri konstaton se pala ankuese ka kërkuar informacion paraprak nga KQZ në lidhje me masat që ky institucion kishte marrë për të garantuar të drejtën për të votuar për personat me aftësi të kufizuara. Pas përfundimit të procesit zgjedhor, në datën 04.05.2021, pala ankuese i është drejtuar KQZ-së duke evidentuar problematikat që ajo kishte konstatuar gjatë monitorimit që i kishte bërë këtij procesi në Bashkitë Durrës, Shijak dhe Krujë. Referuar kësaj shkrese, Komisioneri konstaton se pala ankuese ka paraqitur të njëjtat problematika sikundër ato të paraqitura në ankesën objekt shqyrtimi, por asnjë rast konkret apo anëtar të qendrave të votimit. Nuk rezulton që gjatë procesit zgjedhor në datën 25.04.2021, pala ankuese të ketë raportuar ose të ketë paraqitur ankesë pranë KQZ për marrjen e masave ndaj anëtarëve të qendrave të votimit.

Në problematikat e ngritura nga pala ankuese, kjo e fundit pretendon se anëtarët e qendrave të votimit nuk kanë qenë të trajnuar/informuar për procedurat që duhet të ndiqen në rast ushtrimi të të drejtës së votës nga personat me aftësi të kufizuara dhe për përdorimin e shabllonëve që shërbejnë për ushtrimin e të drejtës së votës nga ana e personave me aftësi të kufizuara në shikim.

Bazuar në informacionin e administruar, rezulton se KQZ ka miratuar Udhëzuesin e Komisionit të Qendrës së Votimit, për Zgjedhjet për Kuvendin 25 Prill 2021. Referuar këtij udhëzuesi, rezulton se nuk ka ndonjë rubrikë të veçantë për procedurën e votimit nga ana e personave me aftësi të kufizuara, përveç parashikimit se, përjashtimisht kjo kategori zgjedhësish lejohet që të asistohet nga dikush tjetër. KQZ, deklaroi se në trajnimet e zhvilluara për administratën zgjedhore, nuk është dhënë informacion për zgjedhësit me aftësi të kufizuara. KQZ, informon se është duke hartuar një modul specifik për realizimin e trajnimit të administratës zgjedhore, që ka të bëjë me procesin e votimit për personat me aftësi të kufizuara.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, KQZ duhet të bëjë pjesë të udhëzimeve dhe trajnimeve për administratën zgjedhore, informacione të posaçme në lidhje me procesin e votimit për personat me aftësi të kufizuara. Pavarësisht këtij detyrimi, Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe rrethanat e ankesës objekt shqyrtimi, nuk u arrit të provoheshin veprime ose mosveprime nga ana e anëtarëve të qendrave të votimit, të cilat kanë cënuar të drejtën e votës për personat me aftësi të kufizuara.

Në lidhje me pretendimin e dytë kundër KQZ-së, Komisioneri vlerëson se, bazuar në Kodin Zgjedhor caktimi i qendrave të votimit dhe për rrjedhojë plotësimi i kushteve për të siguruar aksesueshmërinë e qendrave të votimit për personat me aftësi të kufizuara është detyrim i kryetarëve të vetëqeverisjes vendore. Udhëzimi nr. 1/05.12.2020, ka si qëllim që t'ju vijë në

ndihmë organeve të vetëqeverisjes vendore në përmbushjen e detyrimeve që atyre ju vijnë nga parashikimet e Kodit Zgjedhor, për caktimin dhe vendodhjen e qendrave të votimit.

Komisioneri gjykon se, pavarësisht efikasitetit të mekanizmave të parashikuar në udhëzimin e mësipërm të miratuar nga ana e KQZ-së, përgjegjësia ligjore për të garantuar aksesueshmërinë e qendrave të votimit për personat me aftësi të kufizuara i takon njësive të vetëqeverisjes vendore.

Bazuar në konstatimet e mësipërme, rezulton se njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë dështuar për të garantuar aksesueshmërinë në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuara. Komisioneri vlerëson se KQZ duhet të konsiderojë rishikimin e udhëzimit nr. 1/05.12.2020 me qëllim forcimin e mekanizmit dhe rritjen e rolit monitorues nga ana e KQZ-së në drejtim të përmbushjes së detyrimit nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore për plotësimin e aksesueshmërisë në qendrat e votimit. Në lidhje me aksesueshmërinë e qendrave të votimit, si një detyrim që duhet të përmbushet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë caktimit të QV-ve, Komisioneri vlerëson se, aktet e KQZ-së duhet të kenë referim të shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë tek legjislacioni në fuqi që rregullon kriteret teknike të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, siç është vendimin nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*.

Përfundimisht, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk ka trajtim të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm nga ana e KQZ-së ndaj personave me aftësi të kufizuara në Zgjedhjet për Kuvend të datës 25.04.2021.

B. Shkaku i mbrojtur

Në nenin 1, të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: ***“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.**

Ankuesja ka pretenduar se situata e krijuar sa i përket mungesës së aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në qendrat e votimit në Bashkinë Durrës, Shijak dhe Krujë, përbën mohim të barazisë për personat me aftësi të kufizuara, duke sjellë si pasojë trajtim të pabarabartë të personave me aftësi të kufizuara në krahasim me pjesën tjetër të votuesve. Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, diferencat në trajtim që bazohen në aftësinë e kufizuar, gëzojnë mbrojtje nga diskriminimi në mënyrë të drejtpërdrejtë.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur.

Personat me aftësi të kufizuara, si çdo shtetas të Republikës së Shqipërisë kanë të drejtën të ushtrojnë në baza të barabarta me të tjerët të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, si një e drejtë që garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Neni 45, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sanksionon se : *“Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet.4. Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.”*

Me ligjin nr. 108/2012, datë 15.11.2012, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e OKB-së *“Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”* (në vijim KDPAK). KDPAK përfaqëson standardin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj Konvente është të promovojë, mbrojë dhe sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektin e dinjitetin e tyre të lindur (neni 1). Konventa nuk jep një përkufizim të aftësisë së kufizuar, por pranon se aftësia e kufizuar është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave/pengesave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambjentit që pengojnë pjesmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët (Preambula e KDPAK, gërma “e”). Rrjedhimisht në qendër të vëmendjes nuk duhet të jetë paaftësia/paaftësitë e mundshme, por kufijtë që ngre shoqëria duke penguar gëzimin e të drejtave. Nga ana tjetër KDPAK pranon diversitetin e personave me aftësi të kufizuara.

Bazuar në nenin 116, të Kushtetutës, KDPAK, si akt ndërkombëtar i të drejtave të njeriut jo vetëm që bëhet pjesë e të drejtës së brendshme e detyrueshme për t'u zbatuar, por duke patur edhe përparësi ndaj ligjeve të tjera.

Në nenin 29, KDPAK, njeh të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në jetën politike dhe publike në baza të barabarta me të tjerët, duke sanksionuar se: *“Shtetet palë duhet t'u garantojnë personave me aftësi të kufizuara të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato në baza të barabarta me të tjerët dhe duhet të marrin përsipër: a) Të sigurojnë se personat me aftësi të kufizuara mund të marrin pjesë në mënyrë të plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike mbi bazë të barabartë me të tjerët, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, përfshirë dhe të drejtën dhe mundësinë për personat me aftësi të kufizuara për të votuar dhe për t'u zgjedhur, ndër të tjera duke: i) siguruar që procedurat, mjetet dhe materialet e votimit të jenë të përshtatshme, të mundshme dhe të thjeshta për t'u kuptuar dhe përdorur; ii) mbrojtur të drejtën e personave me aftësi të kufizuara të votojnë me votë të fshehtë në zgjedhje dhe referendume publike, pa kërcënim, të kandidojnë për zgjedhje, të punojnë në zyrë në mënyrë efektive dhe të kryejnë të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisë, duke lehtësuar përdorimin e teknologjive ndihmëse dhe të reja, kur të jetë e përshtatshme; iii) garantuar shprehjen e lirë të vullnetit të lirë të personave me aftësi të kufizuara si zgjedhës dhe*

për këtë qëllim, kur është e nevojshme, me kërkesën e tyre, lejohet asistenca në votim nga një person që zgjidhet prej tyre, ”.

Me qëllim që të bëhet e mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet duhet të marrin masat e duhura për të siguruar akses për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në ambientet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në mjete apo shërbime të tjera të hapura apo të siguruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat duhet të përfshijnë identifikimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave për mundësimin, zbatohen ndër të tjera për: a) ndërtesa, rrugë, transport dhe mjete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, shërbime mjekësore apo vendet e punës; b) informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe shërbimet e emergjencës. (neni 9/1 KDPAK).

Aksesueshmeria ose e thënë ndryshe heqja e pengesave/barrierave, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara. Për rrjedhojë aksesueshmëria është ngushtësisht e lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëria duhet të sigurohet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar. Për rëndësinë që aksesueshmëria paraqet, parashikohet nga Konventa si një e drejtë më vete në nenin 9, por edhe si një nga parimet themelore që përshkon të gjithë Konventën, sipas nenit 3.

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*. Në nenin 3, pika 1, ky ligj përcakton se: *“Aksesueshmëri”* është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve”. Më tej në pikën 3, të këtij neni parashikohet se: *“ 3. “Pengesat” nënkupton: a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore; b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar; c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike; ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.”*

Persona me aftësi të kufizuara, sipas këtij ligji, janë, individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

Në përputhje me qasjen e KDPAK edhe ky ligj sanksionon se aksesueshmëria është një nga parimet e këtij ligji (neni 3/ç) dhe se jetesa e pavarur e personave me aftësi të kufizuara mund të sigurohet nëpërmjet garantimit të aksesueshmërisë, ndër të tjera ofrimin e shërbimeve (neni 5/1)

Jetesa e pavarur, u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët. Neni 5, pika 2 e ligjit nr. 93/2014, përcakton se, “2. *Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht: g) në jetën politike dhe publike, si zgjedhës dhe të zgjedhur;*”

Duke mbajtur parasysh detyrimin që Konventa e OKB-së “*Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*”, ka vendosur për shtetet, jo vetëm për të miratuar të gjitha masat e duhura legislative dhe administrative, si dhe masa të tjera për zbatimin e të drejtave të njohura nga Konventa, por edhe për të marrë të gjitha masat e duhura, përfshirë legjislacionin, për të modifikuar apo zhvlerësuar ligjet, rregulloret, zakonet dhe praktikak ekzistuese që përbëjnë diskriminim ndaj personave me aftësi të kufizuar. Ligji “*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë*”, ka përcaktuar në nenin 20 se: “*Bazuar në këtë ligj, institucionet përgjegjëse ndërmarrin ndryshime graduale në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për të përshtatur formulimin, termat, synimin dhe qëllimin me modelin dhe imazhin bashkëkohor të dëmtimit dhe aftësisë së kufizuar, veçanërisht me autonominë dhe të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për jetesë të pavarur dhe me përfshirjen e tyre në të gjitha sferat e jetës, në kushte të barabarta me të tjerët.*”

Neni 3, i Protokollit 1, të KEDNJ, sanksionon: “*Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës*”.

Deklarata Interpretative e Rishikuar e Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore mbi Pjesëmarrjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në Zgjedhjet, është miratuar nga Këshilli për Zgjedhje Demokratike në mbledhjen e tij të 39-të (Venecia, 15 dhjetor 2011) dhe Komisioni i Venecias, në sesionin e tij të 89-të (Venecia, 16-17 dhjetor 2011)⁷. Ndër të tjera në këtë dokument parashikohet:

“*Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, i miratuar nga Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) në tetor 2002, parashikon se “pesë parimet që qëndrojnë në themel të trashëgimisë zgjedhore të Evropës janë universale, të barabarta, të lira, votimi i fshehtë dhe i drejtpërdrejtë” (pika I). Kodi më tej thekson në pikën I.1.1 se: “E drejta e votës universale do të thotë në parim që të gjitha qeniet njerëzore kanë të drejtë të votojnë dhe të kandidojnë në zgjedhje*”.

Prandaj, personat me aftësi të kufizuara duhet të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar dhe për të marrë pjesë në jetën politike dhe publike si përfaqësues të zgjedhur në baza të barabarta me qytetarët e tjerë. Pjesëmarrja e të gjithë qytetarëve në jetën politike dhe publike dhe në procesin demokratik është thelbësore për zhvillimin e shoqërive demokratike.

E drejta e votës universale

⁷ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2011\)045-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2011)045-e)

E drejta e votës universale është një parim themelor i Trashëgimisë Zgjedhore Evropiane. Personat me aftësi të kufizuara nuk mund të diskriminohen në këtë drejtim, në përputhje me nenin 29 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Procedurat dhe mjediset e votimit duhet të jenë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara në mënyrë që ata të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e tyre demokratike dhe të lejojnë, kur është e nevojshme, ofrimin e ndihmës në votim, duke respektuar parimin se votimi duhet të jetë individual (Kodi , pika I.4.b).

Zbatimi i parimeve të Projektimit Universal dhe pjesëmarrja direkte dhe/ose indirekte e përdoruesit në të gjitha fazat e projektimit janë mjete efektive për përmirësimin e aksesit të qendrave të votimit dhe procedurave zgjedhore për hedhjen e votës dhe për të marrë akses në informacionin për zgjedhjet.”

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: “Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë.” (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese)

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, duke mos parashikuar një të drejtë të veçantë në lidhje me aksesueshmërinë, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u

diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: *çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Në bazë të ligjit, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit përcaktohet se: “Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.*

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i tërthortë, i cili përkufizohet nga neni 3/7, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.

Sa më sipër rezulton se gëzimi dhe ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët i të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe çdo të drejtë tjetër që buron nga ligjet në fuqi, garantohet duke eliminuar diskriminimin formal dhe atë substancial. Diskriminimi mund të rezultojë jo vetëm nga trajtimi i ndryshëm i njerëzve në situata të njëjta (diskriminimi formal), por gjithashtu duke ofruar të njëjtin trajtim për njerëzit në situata të ndryshme (diskriminimi substancial). Ky i fundit quhet diskriminim “i tërthortë”, sepse nuk është trajtimi që ndryshon, por janë më tepër pasojat e atij trajtimi, që do të ndjehen ndryshe nga njerëzit me karakteristika të ndryshme. Diskriminimi i tërthortë ndodh kur një mundësi e cila në dukje është e aksesueshme në realitet përjashton persona të caktuar për shkak se statusi i tyre nuk i lejon ata që të përfitojnë nga kjo mundësi.. Referuar përkufizimit ligjor elementët diskriminimit e tërthortë janë si më poshtë:

- një dispozitë, kriter apo praktikë në dukje neutrale;
- që prek një grup të përcaktuar nga një “shkak i mbrojtur” në një mënyrë shumë më negative;
- duke krahasuar të tjerët në një situatë të ngjashme.

Kriteri i parë i identifikueshëm është një dispozitë, kriter ose praktike neutrale. Në pamje të praktika që ndiqet gjatë procedit zgjedhor është e njëjtë për të gjithë zgjedhësit, të cilët votojnë

dhe hedhin votën e tyre në të njëjtat qendra votimi. Pra nuk ka asnjë trajtim të diferencuar midis zgjedhësve me aftësi të kufizuar dhe atyre pa aftësi të kufizuar.

Kriteri i dytë i identifikueshëm është se dispozita, kriteri ose praktika neutrale e vendos një “grup të mbrojtur” në një disavantazh të caktuar. Për këtë arsye diskriminimi i tërthortë ndryshon nga diskriminimi i drejtpërdrejtë sepse e zhvendos fokusin larg nga trajtimi i ndryshëm për të parë efektet e ndryshme. Në çështjen objekt shqyrtimi, personat me aftësi të kufizuar në pamje të parë nuk kanë patur pengesë që të marrin pjesë në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.04.2021 dhe për të hedhur votën e tyre në qendrat e votimit respektive, por në realitet për shkak të barrierave në qendrat e votimit, e drejta për të marrë pjesë në zgjedhje dhe për të votuar bëhet e pamundur. Pra, barrierat në qendrat e votimit dhe mungesa e aksesueshmërisë në qendrat e votimit e vendos kategorinë e personave me aftësi të kufizuara në kushte më pak të favorshme në raport me zgjedhësit e tjerë. Barrierat dhe mungesa e aksesit në qendrat e votimit prek në një mënyrë më negative kategorinë e zgjedhësve me aftësi të kufizuara.

Në Komentin e Përgjithshëm Nr.6 (2018), “*Mbi barazinë dhe mosdiskriminimin*”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, përcaktohet se:

40. Aksesueshmëria është një parakusht dhe një mjet për të arritur barazinë faktike për të gjithë personat me aftësi të kufizuara. Që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në mënyrë efektive në komunitet, shtetet palë duhet të trajtojnë aksesin në ndërtesa, transportin publik, si dhe shërbimet e informacionit dhe komunikimit, të cilat duhet të jenë të disponueshme dhe të përdorshme për të gjithë personat me aftësi të kufizuara në baza të barabarta me të tjerët. Aksesueshmëria në kontekstin e shërbimeve të komunikimit përfshin ofrimin e mbështetjes sociale dhe komunikuese.

41. Siç u përmend më lart, aksesueshmëria dhe përshtatja e arsyeshme janë dy koncepte të dallueshme të legjislacionit dhe politikave të barazisë:

- a) Detyrat e aksesueshmërisë lidhen me grupet dhe duhet të zbatohen gradualisht, por pa kushte;*
- b) Detyrat e përshtatjes së arsyeshme, nga ana tjetër, janë të individualizuara, zbatohen menjëherë për të gjitha të drejtat dhe mund të kufizohen nga disproporcionaliteti.*

42. Për shkak se realizimi gradual i aksesueshmërisë në ndërtesa, transportin publik dhe shërbimet e informacionit dhe komunikimit mund të marrë kohë, përshtatja e arsyeshme mund të përdoret si një mjet për t'i siguruar ndërkohë akses një individit, pasi është një detyrim i menjëhershme. Komiteti u bën thirrje shteteve palë që të udhëhiqen nga Komenti i tij i Përgjithshëm nr. 2 (2014) “Mbi aksesueshmërinë”

70. Përjashtimi nga proceset zgjedhore dhe format e tjera të pjesëmarrjes në jetën politike janë shembuj të shpeshtë të diskriminimit bazuar në aftësi të kufizuara.Shtetet palë duhet të synojnë:

(b) Të sigurojë që procesi zgjedhor të jetë i aksesueshëm për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë para, gjatë dhe pas zgjedhjeve;

(c) Të sigurojë përshtatje të arsyeshëm për individët me aftësi të kufizuara dhe masa mbështetëse bazuar në kërkesat individuale të personave me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në jetën politike dhe publike;

Referuar Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, parashikohet se:

“14.E drejta për aksesueshmëri për personat me aftësi të kufizuara sigurohet përmes zbatimit të rreptë të standardeve të aksesueshmërisë. Pengesat për të hyrë në objektet ekzistuese, ambjentet, mallrat dhe shërbimet e synuara ose të hapura për publikun duhet të hiqen gradualisht në një mënyrë sistematike dhe, më e rëndësishmja, të monitoruar vazhdimisht, me qëllim që të sigurohet aksesueshmëria e plotë.

23. Meqenëse aksesueshmëria është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të jetojnë të pavarur, siç parashikohet në nenin 19 të Konventës, dhe të marrin pjesë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë në shoqëri, mohimi i aksesit në mjedisin fizik, transportin, teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, dhe ndërtesat dhe shërbimet e hapura për publikun duhen parë në kontekstin e diskriminimit.....

.....

25. Aksesueshmëria lidhet me grupet, ndërsa përshtatja e arsyeshme lidhet me individët. Kjo do të thotë se detyra për të ofruar akses është një detyrë ex ante. Prandaj, shtetet palë kanë për detyrë të ofrojnë aksesueshmërinë përpara se të marrin kërkesa individuale për të hyrë ose përdorur një vend ose shërbim..... Standardet e aksesueshmërisë duhet të jenë të gjera dhe të standardizuara..... Në përputhje me Konventën, shtetet palë nuk lejohen të përdorin masat shtrënguese si justifikim për të shmangur sigurimin e aksesueshmërisë graduale për personat me aftësi të kufizuara. Detyrimi për të zbatuar aksesueshmërinë është i pakushtëzuar, pra subjekti i detyruar që të sigurojë aksesueshmërinë nuk mund të justifikojë mosveprimin për t’u siguruar atë, duke iu referuar barrës për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Detyra e përshtatjes së arsyeshme, përkundrazi, ekziston vetëm nëse zbatimi nuk përbën barrë të tepruar për subjektin.

26. Detyra për të ofruar akomodim të arsyeshëm është një detyrë ex nunc, që do të thotë se është e detyrueshme që nga momenti kur një individ me dëmtim ka nevojë për të në një situatë të caktuar..... Këtu, standardet e aksesueshmërisë mund të jenë një tregues, por mund të mos merren si urdhërues. Akomodimi i arsyeshëm mund të përdoret si një mjet për të siguruar akses për një individ me aftësi të kufizuara në një situatë të caktuar.....”.

Kriteret teknike për eliminimin e barrierave në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike janë miratuar me vendimin nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”. Në nenin 1, të VKM-së së sipërcituar, përcaktohet se: “1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave teknike për eliminimin e pengesave që përcaktohen si “barriera

arkitektonike”. 2. Kjo rregullore ka për qëllim zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike. 3. Fusha e aplikimit të saj shtrihet në:

- të gjitha objektet publike të reja të ndërtuara me fondet e buxhetit të shtetit apo private si dhe në objektet private, që ndërtohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
- godinat dhe hapësirat publike, ndërtimet e reja me karakter të përkohshëm, ose në ato ekzistuese nëse do t'i nënshtrohen rikonstruksionit;
- ndërtesat dhe hapësirat publike që i nënshtrohen çfarëdolloj ndërhyrjeje ndërtimi që ka të bëjë me heqjen e kufizimit të mundësisë së pamjes dhe fushëpamjes, që të paktën, qoftë edhe pjesërisht, është pjesë e ndërhyrjes;
- ndërtesat dhe hapësirat publike që janë, tërësisht ose pjesërisht, objekt i ndryshimit të destinacionit nëse do të jetë në përdorim publik, si edhe për shërbime të veçanta për përdorim publik.”

Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK), miratoi Vëzhgimet përmblyëse mbi raportin fillestar të Shqipërisë, në mbledhjen e tij të 503-të, të mbajtur më 16 shtator 2019⁸. Në lidhje me të drejtën e personave me aftësi të kufizuara në jetën politike dhe publike, Komiteti shprehet i shqetësuar për mungesën e aksesueshmërisë në të gjitha fazat e procesit zgjedhor, në veçanti aksesueshmërinë e qendrave të votimit dhe materialeve të votimit, për personat me aftësi të kufizuara.⁹ KDKPAK rekomandon marrjen e masave për të lejuar akses fizik të papenguar në votim, vendosjen e mekanizma të sigurt për të garantuar fshehtësinë e votimit dhe të sigurohet disponueshmëria e materialeve dhe informacioneve të tjera zgjedhore në formate të aksesueshme, duke përfshirë gjuhën e shenjave, *Braille* dhe leximin e thejstë, në përputhje me Komentin e Përgjithshëm të Komitetit nr. 2¹⁰.

Në Raportin Përfundimtar të Misionit të Kufizuar të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të datës 25 prill 2021, konstatohet nga vëzhguesit e OSBE/ODIHR-it se: “*Shumica e QV-ve të vizituara nuk ishin pa pengesa për personat me aftësi të kufizuara fizike.*”¹¹

E drejta e votës është e drejtë thelbësore dhe jo privilegj. E drejta e votës universale kërkon që të gjithë qytetarët të kenë të njëjtat mundësi për të marrë pjesë në jetën politike të vendit, siç parashikohet në marrëveshjet ndërkombëtare dhe në të drejtën kombëtare.

Aksesueshmëria e plotë në çdo fazë të procesit të votimit në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuara duhet të jetë rregulli dhe jo përjashtimi. Aksesueshmëria është një kërkesë e pakushtëzuar dhe nuk mund të zbehet duke referuar tek “barra disproporcionale” pasi është

⁸ https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD%2fC%2fALB%2fC O%2f1&Lang=en

⁹ Si më sipër, paragrafi 47.

¹⁰ Si më sipër, paragrafi 48.

¹¹ Raporti Përfundimtar i Misionit të Kufizuar të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, varianti në gjuhën shqipe, faqe 28. Link: <https://www.osce.org/files/f/documents/4/c/495052.pdf>

parakusht për gëzimin e plotë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë pjesëmarrjen e tyre në jetën politike dhe shoqërore në pozitë të barabartë me të tjerët.

Në praktikë, aksesit i personave me aftësi të kufizuara në të drejtat e tyre në baza të barabarta me ato të personat pa aftësi të kufizuara shpesh mbetet një mendim i dëshiruar që rezulton i pamjaftueshme, gjë që përkthehet në pjesëmarrje dukshëm më të ulët të personave me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor dhe i marginalizon më tej këtë pjesë të shoqërisë.

Gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi, se në përfundim të procedit zgjedhor nuk gjenerohen të dhëna dhe statistika në lidhje me numrin e personave me aftësi të kufizuara të cilët kanë ushtruar të drejtën e votës.

Në referim edhe të nenit 31, të Konventës “*Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*”, Komisioneri vlerëson se, është e nevojshme që KQZ-ja të përcaktojë dhe të rregullojë mënyrën e mbledhjes së të dhënave në lidhje me numrin e personave me aftësi të kufizuara që kanë ushtruar të drejtën e votës. Këto të dhëna janë të rëndësishme për të identifikuar dhe për të adresuar barrierat me të cilat ndeshen personat me aftësi të kufizuara gjatë ushtrimit të të drejtës së votës. Aktualisht gjatë procesit zgjedhor administrohen të dhëna paraprake në lidhje me identifikimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuara të regjistruar, por jo se sa prej tyre kanë ushtruar efektivisht të drejtën e votës. Mbledhja dhe analiza e të dhënave, para dhe pas procesit zgjedhor, janë masa thelbësore për monitorimin e politikave dhe ligjeve kundër diskriminimit. Të dhënat para dhe pas procesit zgjedhor, duhet të ndahen jo vetëm sipas llojit të aftësisë së kufizuar, por edhe sipas kategorive ndërsektoriale.

Masat alternative ose të përkohshme të aksesueshmërisë nuk duhet të përdoren si zëvendësues i përhershëm, në vend të sigurimit të aksesit të plotë të qendrave të votimit.

Bazuar në nenin 33 pika 7/1 “*Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim*”.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke provuar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar

sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njëherë nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.¹²

Standartet teknike të aksesueshmërisë janë miratuar prej një kohe të gjatë dhe e drejta ndërkombëtare e ratifikuar nga Shqipëria dhe legjislacioni kombëtar vendosin detyrimin për të garantuar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në mënyrë që të garantohet në baza të barabartë me të tjerët e drejta e tyre për të marrë pjesë në jetën politike të vendit.

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje dhe provave të vëna në dispozicion nga palët, rezultoi se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm dhe faktit që votuesve më aftësi të kufizuara duhet t'i krijoheshin kushtet për të votuar në mënyrë të barabartë me pjesën tjetër të votuesve, nuk u vendosën në dispozicion të Komisionerit fakte që provojnë se, për zgjidhjen e kësaj situate janë ndërmarrë hapa për t'i garantuar akses të barabartë personave me aftësi të kufizuara në ushtrimin e të drejtës për të votuar.

Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor të sipërcituar, detyrimi për të vendosur qendrat e votimit në godina që kanë aksesin e nevojshëm për votuesit me aftësi të kufizuara, është i organeve të vetëqeverisjes vendore, pra i Bashkisë Durrës, Krujë dhe Shijak, në çështjen objekt shqyrtimi.

Gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, nga ana e Bashkisë Durrës dhe Bashkisë Shijak, nuk u parashtrua asnjë pretendim në lidhje me mungesën e aksesueshmërisë në qendrat e votimit në juridiksionin e tyre.

Komisioneri arrin në përfundimin se mosplotësimi standarteve të aksesueshmërisë në qendrat e votimit në Bashkinë Durrës dhe në Bashkinë Shijak, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në të drejtën e tyre për të votuar në Zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021 dhe për të marrë pjesë në jetën politike. Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri nuk gjen asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, në lidhje me trajtimin të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se Bashkia Durrës dhe Bashkia Shijak, kanë dështuar që të trajtojnë në mënyrë të diferencuar nevojat e personave me aftësi të kufizuara për të patur akses në qendrat e votimit, duke i vendosuar ata në një situatë diskriminuese.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përputhje me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”. Ky ligj në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen

¹² https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit ose parandalimin e situatave diskriminuese. Ky ligj, përmes nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri, në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, në kuadër të ushtrimit të së drejtës së votës në Zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021, nga ana e Bashkisë Durrës.
2. Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, në kuadër të ushtrimit të së drejtës së votës në Zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021, nga ana e Bashkisë Shijak.
3. Konstatimin e mosdiskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, në kuadër të ushtrimit të së drejtës së votës në Zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021, nga ana e Bashkisë Krujë.
4. Konstatimin e mosdiskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, në kuadër të ushtrimit të së drejtës së votës në Zgjedhjet për Kuvend të 25 Prillit 2021, nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Në referim të pikës 1, Bashkia Durrës, të marrë masa për të garantuar aksesueshmërinë e plotë në qendrat e votimit, për personat me aftësi të kufizuara, në zbatimin të kriterëve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
6. Në referim të pikës 2, Bashkia Shijak, të marrë masa për të garantuar aksesueshmërinë e plotë në qendrat e votimit, për personat me aftësi të kufizuara, në zbatimin të kriterëve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
7. Bashkia Durrës, Bashkia Shijak, Bashkia Krujë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si palë të përfshira në procesin zgjedhor, sipas fushës respektive të përgjegjësisë, duhet të marrin masa për të mbledhur në mënyrë të saktë dhe të qartë dhe për të monitoruar në mënyrë efektive, të dhënat për personat me aftësi të kufizuara, para çdo procesi votimi, me qëllim adresimin e duhur të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.
8. Të rekomandojë, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për marrjen e masave të mëposhtme:
 - a. të rishikojë Udhëzimin e Komisionit Rregullator nr. 1, datë 05.12.2020 “*Për përcaktimin e rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet*” me qëllim përfshirjen e të gjitha aspekteve të aksesueshmërisë që duhet të plotësojnë qendrat e votimit, sipas legjislacionit në fuqi për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara;
 - b. të miratojë udhëzime të posaçme lidhur me procesin e votimit të personave me aftësi të kufizuara dhe të zhvillojë trajnime të posaçme për administratën zgjedhore lidhur me procesin e votimit nga personat me aftësi të kufizuara;
 - c. të kontrollojë dhe të monitorojë, brenda kompetencave të veta, zbatimin e detyrimeve sa i takon personave me aftësi të kufizuara, para, gjatë dhe pas zgjedhjeve;

- d. të marrë masa për të mbledhur të dhëna në lidhje me numrin e personave me aftësi të kufizuar të regjistruar në zgjedhje dhe atyre që kanë votuar në zgjedhje, sipas llojit të aftësisë së kufizuar, por edhe sipas kategorive ndërsektoriale, duke përfshirë edhe aspektin gjinor.
9. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, subjektet e mësipërme, detyrohen që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
10. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
11. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku : Aftësia e kufizuar
Fusha : E drejta për të votuar
Lloji i vendimit: Diskriminim
Forma: Diskriminim i tërthortë